

Ligji Nr. 05/L-083**PËR FALIMENTIMIN****Kuvendi i Republikës së Kosovës,**

Në mbështetje të Nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR FALIMENTIMIN**Neni 1****Qëllimi**

1. Ky ligj rregullon dhe përcakton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me falimentimin dhe josolvencën e shoqërive tregtare, dispozitat për mbrojtjen, likuidimin dhe shpërndarjen e aseteve të debitorit falimentues te kreditorët dhe dispozita për riorganizimin dhe lirin nga borxhi për shoqëritë tregtare.

2. Ky ligj përcakton kushtet dhe dispozitat për:

2.1. inicimin dhe hapjen e procedurës së falimentimit ndaj debitorit në falimentim;

2.2. procedurën e falimentimit dhe zhvillimin e procedurës së falimentimit;

2.3. pasojat juridike të hapjes dhe përmbylljes së procedurës së falimentimit;

2.4. riorganizimin e debitorit në vështirësi financiare, kur ekziston mundësia që debitori të vijë në gjendje falimentimi;

2.5. pasojat e lirit nga borxhi të debitorit pas përfundimit të suksesshëm të riorganizimit dhe likuidimit sipas këtij ligji.

3. Ky ligj është pjesërisht në përputhshmëri me Rregulloren e BE-së 2015/848 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 Maj 2015 mbi Procedurat e Falimentimit.

Neni 2**Fushëveprimi**

1. Ky ligj është i zbatueshëm ndaj të gjitha Shoqërive Tregtare të rregulluara me Ligjin për Shoqëritë Tregtare ose me një ligj pasardhës.

2. Ky ligj nuk është i zbatueshëm ndaj:

- 2.1. institucioneve të Republikës së Kosovës;
- 2.2. cilitdo organ qeveritar;
- 2.3. institucioneve financiare sipas përcaktimeve të ligjit që rregullon bankat, institucionet financiare dhe institucionet financiare jobankare; dhe
- 2.4. kompanive të sigurimeve dhe ndërmjetësve të sigurimeve të cilët rregullohet me ligj të veçantë për kompanitë e sigurimeve dhe ndërmjetësit e sigurimeve;
- 2.5. fondeve pensionale ose ofruesve të skemave pensionale, të licencuara dhe rregulluara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;
- 2.6. ndërmarrjeve shoqerore nën administrim të Agjencionit Kosovar të Privatizimit;
- 2.7. ndërmarrjet publike të rregulluara më Ligjin për ndërmarrjet publike ose më një ligj pasardhës.

Neni 3

Shprehjet dhe përkufizimet

1. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **“Shpenzim administrativ”** ose **“shpenzime administrative”** shpenzimi i shkaktuar nga pasuria e falimentimit prej momentit të hapjes së rastit, të cilat janë shpenzime të nevojshme për mirëmbajtjen dhe ruajtjen e pasurisë së falimentimit;

1.2. **“Paaftësi paguese e shpenzimeve administrative”** procedura e falimentimit në të cilën nuk ka asete të mjaftueshme për të paguar në tërësi të gjitha shpenzimet administrative dhe kërkesat prioritare;

1.3. **“Administrator”** personi i emëruar sipas Kapitullit VII të këtij ligji si përfaqësues i pasurisë së falimentimit;

1.4. **“Entitet i ndërlidhur”**:

1.4.1. një entitet në të cilin debitori ka në pronësi të paktën njëzet për qind (20%) të kapitalit drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthorët; ose

1.4.2. një entitet i cili ka në pronësi të paktën njëzet për qind (20%) të kapitalit të debitorit drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthorët.

1.5. **“Pasuria e falimentimit”** pasuria e falimentimit që përbëhet nga e gjithë pasuria e debitorit në kohën e paraqitjes së kërkesës për falimentim, si dhe nga e gjithë pasuria e mbledhur gjatë kohës së procedurës dhe rrjedhës normale të biznesit, duke përfshirë të gjitha interesat pronësore pa marrë parasysh a janë sende të prekshme ose të paprekshme, të luajtshme ose të paluajtshme si dhe të gjithë interesin e mbledhur në emër të debitorit në pasuritë e ngarkuara në favor të debitorit ose palëve të treta. Pasuria e tillë do të përfshijë por nuk do të kufizohet me:

1.5.1. gjithë pasurinë e luajtshme, të paluajtshme, materiale dhe jomateriale, kudo që gjendet, qoftë në administrim të debitorit ose të personave të tretë;

1.5.2. kërkesat dhe veprimet juridike të debitorit kundër personave të tretë;

1.5.3. fitimet nga veprimet që përfshijnë të ardhurat që arkëtohen prej transfereve të pandershme apo të privileguara;

1.5.4. trashëgimet dhe fondet tjera të pranuar brenda gjashtë 6 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës;

1.5.5. qiradhënien, të ardhurat dhe fitimet që dalin prej përdorimit të pronësisë së pasurisë ose nga veprimet e biznesit të debitorit; dhe

1.5.6. të drejtat e kontraktuara, licencat, ose të drejtat tjera të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi.

1.6. **“Prona rënduese”** prona e cila mund të jetë pa vlerë ose pa ndonjë vlerë të rëndësishme për pasurinë e falimentimit ose e cila e rëndon pasurinë e falimentimit aq shumë sa ruajtja e saj do të shkaktonte shpenzime me të mëdha se sa shitja e saj;

1.7. **“Aktivitet afarist”** secili aktivitet i rregullt ose te përsëritur që përfshinë ofertimin, ofrimin ose prodhimin e mallrave, shërbimeve, pronës dhe/ose punëve për ose ndaj personave fizik ose juridik në shkëmbim të pagesës ose kompenzimit; përjashtimisht një punëmarrës që ofron shërbime ndaj punëdhënësit të tij nuk konsiderohet se është duke zhvilluar “aktivitet afarist” deri në masën që ato punë ose shërbime ofrohen në kuadër të kontratës së punës të lidhur në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit;

1.8. **“Shoqëri Tregtare”** është term i përgjithshëm që do të thotë dhe përfshin çfarëdo lloji të shoqërisë tregtare të themeluar në Kosovë sipas ligji që rregullon themelimin dhe funksionimin e shoqërive tregtare, siq janë bizneset individuale, ortakëritë e përgjithshme, shoqëritë komandite, shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë aksionare dhe degët e shoqërive të huaja tregtare;

1.9. **“Kërkesë”** kërkesa dhe e drejtën për t’u paguar në bazë të ekzistimit të një borxhi, një detyrimi ligjor, një kontrate ose çfarëdo obligimi tjetër ligjor, pa marrë parasysh a është detyrimi i likuiduar ose i palikuiduar, i maturuar ose i pamaturuar, i kontestuar ose i pakontestuar, i siguruar ose i pasiguar, të arritshme ose fikse:

1.9.1. borxh i likuiduar është borxhi i cili nuk është lëndë në një kontest gjyqësor ose në arbitrazhit. Një borxh i cili është i vendosur me vendim gjyqësor konsiderohet borxh i likuiduar;

1.9.2. borxh i maturuar është borxhi që vjen në bazë të një kontrate dhe është bërë i maturuar (i arritur) qoftë nga kalimi i afatit ose me zgjedhjen e palëve. Borxhet e maturuara përfshijnë detyrimet nga kërkesat, për cka kërkesat janë bërë dhe është kështu i borxhit për të cilin njëra palë ka përsheptuar të gjitha kështet për të qenë në kohë;

1.9.3. borxhi i kontestuar përfshin borxhin që rrjedh nga një kontest gjyqësor ose i arbitrazhit;

1.9.4. borxh i siguruar është borxhi i siguruar me peng ose hipotekë;

1.9.5. borxh i kushtëzuar është borxhi për të cilin ende nuk kanë ndodh të gjitha kushtet e detyrimit. Borxhi i kushtëzuar përfshin borxhin mbi garancionin për të cilin debitori kryesor nuk është në mos-permbushje, dhe një kërkesë për garancion mbi produktin që ende punon. Borxhi që rrjedh nga një kontest gjyqësor ose i arbitrazhit nuk është i kushtëzuar; edhe i palikuiduar deri në momentin kur gjykata e terheq vendimin e saj;

1.10. **“I afërm”** të afërmit në të gjitha gjinitë në vijë të drejtë dhe në vijë të tërthortë deri në shkallë të dytë;

1.11. **“Inicimi i procedurës së falimentimit:**

1.11.1. në rastet kur procedura e falimentimit inicohet vullnetarisht nga debitori, dita në të cilën debitori ka deponuar kërkesën në gjykate për inicim të procedurës së falimentimit; ose

1.11.2. në secilin rast tjetër, dita në të cilën dy ose më shumë kreditor dorëzojnë kërkesën për fillimin e rastit kundër një debitori të kualifikuar sipas këtij ligji;

1.11.3. në rastet e inicimit vullnetar të rastit, dita e fillimit të procedurës së falimentimit konsiderohet dita në të cilën gjykata e fillon procedurën e falimentimit.

1.12. **“Aktivitet konsumator”** përdorimi ose blerja e mallrave ose shërbimeve për qëllime të përdorimit personal, familjar ose shtëpiak. Investimi, kursimi i parave ose gjërave tjera me vlerë nuk konsiderohet “aktivitet konsumator”;

1.13. **“Informata kontaktuese”** së paku informatat kontaktuese që janë të mjaftueshme për komunikim të korrespondencave përmes postës së rregullt ose elektronike. Informatat kontaktuese përfshijnë një adresë të vlefshme për dërgim të shkresave me postë, një adresë elektronike (e-mail) ose një numër të telefonit. Për personat juridik, informatë kontaktuese nënkupton emrin dhe titullin e vendit të punës të personit përmes të cilit identifikohet personi juridik (qoftë në procedurat para gjykatës ose në një mënyrë tjetër të qasshme për publikun) i autorizuar për të pranuar njoftime dhe shkresa, ose nëse një person i tillë është i paidentifikueshëm atëherë emri dhe titulli i vendit të punës i një personi i cili ka autorizime për t'u përgjigjur në njoftime dhe shkresa. Të gjithë entitetet janë të obliguara të japin informatat kontaktuese në disipas këtij ligji, ai entitet është i obliguar të ofroj të gjitha informatat kontaktuese që i ka dhe i ndalohet ofrimi i informatave të pjesshme ose të pasakta. Obligimi për të ofruar informatat kontaktuese me urdhër të gjykatës vlen edhe ndaj entiteteve publike, në veçanti ndaj Agjencionit për Regjistrim Civil të Republikës së Kosovës dhe ciltodo entitet tjetër publik që mund të ketë në dispozicion informata kontaktuese në lidhje me palën;

1.14. **“Gjykata”:**

1.14.1. Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për çështje ekonomike;

1.14.2. cilado Gjykatë në Republikën e Kosovës, kur konteksti i dispozitës specifike në këtë ligj nënkupton që bëhet fjalë për një Gjykatë tjetër;

1.15. “**Kreditor**” një entitet që ka një kërkesë ndaj debitorit, kërkesë e cila ka lindur që para inicimit të procedurës së falimentimit ose në momentin e inicimit të procedurës së falimentimit;

1.16. “**Komiteti i kreditorëve**” trupa e cila përfaqëson kreditorët dhe është e themeluar në përputhje me këtë Ligj, me kompetenca konsultative dhe kompetenca tjera sipas dispozitave të këtij Ligji;

1.17. “**Ditë**” çdo ditë kalendarike;

1.18. “**Debitor**” një entitet ndaj të cilit është iniciuar procedura e falimentimit sipas këtij Ligji;

1.19. “**Debitori në posedim**” debitori në procedurë të riorganizimit në rastet kur Gjykata nuk emëron Administrator Falimentimi;

1.20. “**Personi jo i interesuar**” entitetin i cili:

1.20.1. nuk është kreditor, pronar ose aksionar i debitorit, ose një person i brendshëm i debitorit;

1.20.2. nuk është dhe nuk ka qenë drejtor, zyrtar, nëpunës ose punëtor i debitorit gjatë dy viteve të fundit nga dita e dorëzimit të kërkesës për inicim të procedurës së falimentimit;

1.20.3. nuk ka asnjë interes material të drejtpërdrejtë ndaj pasurisë së falimentimit ose përmes kreditorëve, pronarëve ose aksionarëve të debitorit, dhe asnjë lidhje tjetër, për çfarëdo arsye me debitorin;

1.21. “**Entitet**” një person fizik ose juridik, qeverinë dhe agjencionet e pavarura të Republikës së Kosovës;

1.22. “**Bartës i ekuitetit**” një bartës ose titullar të të drejtave pronësore mbi aksionet ose të drejtave tjera të ngjashme pronësore në një shoqëri tregtare, që mund të jetë aksionari, pronari, ortaku ose ngjashëm;

1.23. “**Interes në Ekuitet**” pronësia mbi kapitalin ose një të drejtë tjetër pronësore ndaj aksioneve ose pjesëve në një person juridik ose shoqëri tjetër tregtare, bartës të cilit mund të jenë aksionari, pronari, ortaku ose ngjashëm;

1.24. “**Organ qeveritar**” vetëm qeverinë, ministritë, komunat, agjencionet e pavarura dhe cilëndo njësi tjetër të themeluar sipas Kushtetutës dhe Ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës;

1.25. “**I brendshëm**”:

1.25.1. entiteti i ndërlidhur;

1.25.2. një person që është anëtar i cilësdo trupë qeverisëse apo menaxhmentit të debitorit apo është një pozitë të kontrollit substancial mbi debitorin;

1.25.3. një person me qasje në informacione që në përgjithësi nuk janë të hapura për publikun, që kanë të bëjnë me vendimet apo kushtet financiare të debitorit; dhe

1.25.4. anëtar i familjes së ngushtë apo kushërinj të afërt të personave të përmendurve në nën-paragrafët 1, 2 dhe (3) të këtij paragrafi.

1.26. **“Josolvenca”** dhe/ose **“pa-aftësia paguese”** është gjendja financiare në të cilën ndodhet një entitet i cili përgjithësisht është i paaftë të paguaj kërkesat kur maturohen ose kur detyrimet e tij e tejkalojnë vlerën e asetëve;

1.27. **“Procedura e falimentimit”** procedura vullnetare ose të detyrueshme të falimentimit të iniciuar sipas këtij Ligji;

1.28. **“Individ”** çdo person fizik të regjistruar sipas dispozitave ligjore që rregullojnë shoqëritë tregtare;

1.29. **“Barrë”** çfarëdo të drejte mbi pronën, qoftë ajo e drejtë e plotë ose e pjesshme, mbi sendin ose tjetër, pa marrë parasysh a është në pronësi të debitorit ose një personi tjetër, e mbajtur nga kreditori për të siguruar një ose më shumë obligime të debitorit. Barrat përfshijnë hipotekat, pengun dhe interesat e siguruar;

1.30. **“Likuidimi”** procedurat për shitje të pronave të debitorit me qëllim të shpërndarjes së mjeteve ndaj kreditorëve, në përputhje me këtë Ligji;

1.31. **“Person juridik”** është shprehje e përgjithshme që nënkupton një shoqëri, duke përfshirë shoqërinë tregtare, që ka një identitet juridik të veçantë dhe të ndarë nga ai i anëtarëve ose aksionarëve të saj;

1.32. **“Hapja e rastit”**:

1.32.1. në rastet vullnetarisht të iniciuara, data në të cilën debitori vullnetarisht dorëzon kërkesën për likuidim në gjykatë; ose

1.32.2. në rastet jovullnetarisht të iniciuara, data në të cilën gjykata merr vendimin mbi kërkesën jovullnetare të kreditorit;

1.33. **“Rrjedha e zakonshme e biznesit”** ose **“rrjedha e zakonshme e afarizmit”** i referohet transaksioneve dhe veprimeve që:

1.33.1. kanë qenë të rregullta për debitorin para deponimit të kërkesës për falimentim, dhe

1.33.2. kushtet e zakonshme të afarizmit në të cilat debitori afaron;

1.34. **“Pari passu”** është parimi i cili përcakton se kreditorët në situata të ngjashme

trajtohen dhe paguhen proporcionalisht për kërkesat e tyre nga pasuria e falimentimit e cila është në dispozicion për shpërndarje ndaj atij rangu të kreditorëve;

1.35. **“Palë/person e interesuar”** përfshinë debitorët, administratorët falimentues, kreditorët, bartësit e ekuitetit, komitetet e kreditorëve dhe organet qeverisëse. Entitetet me interesa të largëta dhe të shpërndara jopasurore nuk konsiderohen palë të interesuara. Palë e interesuar nënkupton cilado palë:

1.35.1. që i ndikohen të drejtat pasurore, monetare, obligimet dhe interesat tjerë si rezultat i procedurës së falimentimit; ose

1.35.2. që ka obligim ligjor për mbikëqyrjen ose administrimin e procedurës së falimentimit;

1.36. **“Ruajtja e vlerës”** masa e urdhëruar nga gjykata me qëllim të ruajtjes së vlerës ekonomike të pronës së ngarkuar ose pronës në të cilën debitori dhe pala e tretë së bashku kanë interesa në procedurë të falimentimit. Gjykata mund të urdhërojë lehtësitë vijuese me qëllim të ruajtjes së vlerës:

1.36.1. kompensimin me pagesë në të gatshme ndaj kreditorit të siguruar në vlerë proporcionale me vlerën e zvogëluar të pasurisë nga fillimi i procedurës së falimentimit si dhe dëmshpërblimin për humbjet e tashme apo të parashikuara për atë pronë të ngarkuar si kolateral;

1.36.2. dhënija e kolateralit shtesë për të kompenzuar rrënjën e vlerës së pronës ose për të kompenzuar humbjet;

1.36.3. pagimin e mjeteve të realizuara si rezultat i shitjes, përdorimit ose dhënies me qira të pronës së ngarkuar si kolateral ndaj kreditorit, deri në vlerën e kërkesës së siguruar;

1.36.4. riparimin, mirëmbajtjen, mbulimin me policë të sigurimit ose sigurimin fizik, sipas nevojës, me qëllim të zgjidhjes së problemit; ose

1.36.5. masat tjera mbrojtëse ose kompenzuese që mund ti vlerësoj të nevojshme gjykata me qëllim të mbrojtjes së vlerës së pasurisë së kreditorit;

1.37. **“Provë”** ose **“provat”** kur përdoret në lidhje me faktet ose situatën e krijuar nënkupton se entiteti i cili e ka barrën e provës duhet të vërtetoj përmes provës ose provave të besueshme pretendimin e tij;

1.38. **“Riorganizimi”** procesi përmes të cilit tentohet të vendoset situata e mirë dhe e qëndrueshme financiare e biznesit të debitorit, të ruhen vendet e punës dhe biznesi të vazhdoj me operimin. Riorganizimi mund të marrë forma tjera, duke përfshirë faljen e borxheve, shndërrimin e borxheve në ekuitet për kreditorin dhe shitjen e biznesit ose pjesëve të biznesit;

1.39. **“Kërkesë e siguruar”** kërkesa ndaj të cilës kreditori ka një barrë të regjistruar pranë institucioneve kompetente (hipotekë, peng, barrë);

1.40. **“Kreditor i siguruar”** kreditori, kërkesa e të cilit është e siguruar;

1.41. **“Transfer”** ose **“bartje”** nënkupton çdo mënyrë, të drejtpërdrejt apo tërthorazi, të tjetërsimit, shitjes, këmbimit, dhurimit, derdhjes së mjeteve, disponimit, dhënies së pengut ose hipotekës, ose të drejtave tjera;

1.42. **“Kërkesë e pasiguruar”**:

1.42.1. një kërkesë për të cilën kreditori nuk ka ndonjë barrë; ose

1.42.2. nëse kreditori ka barrë ndaj kërkesës, kërkesë e pasiguruar mbetet diferenca në mes të;

1.42.3. shumës totale të kërkesës; dhe

1.42.4. vlerës së kolateralit në momentin e hapjes së rastit;

1.43. **“Kreditor i pasiguruar”** konsiderohet kreditori i cili ka një kërkesë të pasiguruar.

2. Për qëllime të zbatimit të Kapitulli IX të këtij ligji, termat dhe nocionet në këtë Kapitull kanë këtë kuptim:

2.1. **“gjykatë e huaj”** trupa gjyqësore ose autoritetin tjetër kompetent për të kontrolluar dhe mbikqyrur procedurën e huaj;

2.2. **“procedurë e huaj”** një procedurë juridike ose administrative në shtetin e huaj, përfshirë një procedurë për masë të përkohshme, në përputhje me ligjin që trajton falimentimin, ku asetet dhe punët e debitorit janë nën kontroll ose mbikqyrje të gjykatës së huaj me qëllim të riorganizimit ose likuidimit;

2.3. **“procedura e huaj kryesore”** procedura e huaj e cila zhvillohet në shtetin e huaj ku debitori ka qendrën kryesore të veprimtarisë së tij;

2.4. **“procedura e huaj jo-kryesore”** procedura e huaj, tjetër prej procedurës kryesore, e cila zhvillohet në shtetin ku debitori ka një seli të themeluar në kuptim të paragrafit 1.6 të këtij neni;

2.5. **“përfaqësuesi i huaj”** një person ose trupë, përfshirë atë të emëruar përkohësisht, i autorizuar në procedurë të huaj të administrojë me riorganizimin ose likuidimin e aseteve të debitorit ose i autorizuar të veprojë si përfaqësues i procedurës së huaj;

2.6. **“seli e themeluar”** cilindo vend ku debitori operion dhe zhvillon aktivitetin ekonomik jo-tranzitor në shitje të produkteve ose ofrim të shërbimeve.

Neni 4

Parimet e përgjithshme të ligjit për falimentimin

1. Gjatë zbatimit dhe interpretimit të këtij ligji, gjykata aplikon parimet e përgjithshme të ligjit për falimentimin, të përcaktuara në këtë nen.

2. Gjatë procedurës së likuidimit, gjykata i ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që:

2.1. përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit maksimizon kthimin e përgjithshëm të pasurisë në favor të kreditorëve;

2.2. shpërndarjet ndaj të gjithë kreditorëve të kategorisë së njëjtë të prioriteteve bëhen sipas parimit *pari passu*;

2.3. debitori person juridik nuk do të jetë pronar i aseteve të tij në përfundim të procedurës së likuidimit dhe do të fshihet si biznes aktiv në regjistrin e bizneseve me shënimin "i likuiduar";

2.4. debitori individual nuk do të jetë pronar i aseteve të tij të shfrytëzuara për biznes të cilat janë administruar gjatë procedurës së falimentimit, në përfundim të procedurës së likuidimit. Fakti se debitori individual ka falimentuar shënohet në regjistrin e bizneseve gjatë çdo regjistrimi të ri të një biznesi nga debitori dhe anëtarët e ngushtë të familjes për pesë vite nga dita e përfundimit të procedurës së falimentimit dhe fakti se debitori individual ka falimentuar shënohet edhe në regjistrin e kredive të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,

2.5. procedura e falimentimit është procedurë urgjente;

2.6. nuk lejohet asnjë lloj pezullimi apo ndërprerje e procedurës së falimentimit.

3. Në procedurë të riorganizimit, gjykata duhet të siguroj që procedura e riorganizimit, nëse ka sukses, ka mundësi të:

3.1. ruan vendet e punës ose krijon vende të reja të punës;

3.2. ruan vlerën e aseteve deri në masën në përputhje me riorganizimin.

4. Në të gjitha procedurat, gjykata duhet të marr masa të siguroj që:

4.1. detyrimet e debitorëve dhe të drejtat dhe privilegjet e kreditorëve nuk mund të zhvlerësohen ose ndryshohen përveç kur parashihet me këtë ligj;

4.2. të drejtat sendore të kreditorëve të siguruar ose të kreditorëve të cilët kanë barra sendore nuk mund të zhvlerësohen ose ndryshohen përveç kur parashihet me këtë ligj;

4.3. përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit do të merr në posedim të gjitha asetet, të prekshme ose të pa prekshme, së bashku me të gjitha të drejtat, kërkesat ose detyrimet ndaj atyre aseteve, të krijuara si rezultat i ligjeve tjera, përveç nëse ndonjë dispozitë e këtij ligji përcakton ndryshe.

4.4. në rastet e debitorëve individual, vetëm asetet e debitorit të shfrytëzuara në aktivitete të biznesit mund të përdoren për procedurë të likuidimit për të përmbushur kërkesat e kreditorëve;

4.5. në përputhje me dispozitat për riorganizimin të përcaktuara në këtë ligj, hapja e rastit do të shpejtojë maturitetin e të gjitha kërkesave ndaj debitorit të cilat janë të pamaturuara në momentin e hapjes së rastit;

4.6. parimi i përgjegjësisë së kufizuar të aksionarëve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, ortakëve të kufizuar në shoqëritë komandite dhe aksionarëve në shoqëritë aksionare do të respektohen në çdo rast dhe pronarët, ortakët ose aksionarët nuk do të jenë përgjegjës për detyrimet e shoqërive të tyre përveç në rastet kur ekziston një punë juridike, një garancion ose një ligj i veçantë që rregullon ndryshe këtë çështje.

Neni 5

Rregullat e interpretimit

1. Gjatë interpretimit të fjalëve dhe nocioneve në këtë ligj:

1.1. fjala “përfshirë” ose “përfshinë” nënkupton gjithmonë “përfshinë, pa kufizime” dhe është indikacion i një liste ilustruese dhe jo gjithëpërfshirëse;

1.2. kur një fjalë ose nocion është i shkruar në shumës, i njëjti kuptim vlen edhe për atë fjalë kur është e shkruar në njëjës; dhe

1.3. kur flitet për entitetin në gjininë femërore, mashkullore ose asnjëjësë, nuk paraqet asnjë ndryshim dhe ka kuptimin e njëjtë.

Neni 6

Debitori i falimentimit

1. Përfshihet nga paragrafi 2 i këtij neni, secila shoqëri tregtare mund të jetë debitor.

2. Debitor sipas këtij ligji nuk mund të jetë:

2.1. Republika e Kosovës;

2.2. Institucionet Publike ;

2.3. institucionet financiare të definuara në ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare;

2.4. një kompani e sigurimeve, ndërmjetës i sigurimeve, broker ose institucion financiar sigurues i rregulluar dhe licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;

2.5. një fond pensional ose ofrues i skemave pensionale, i licencuar dhe rregulluar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës;

2.6. ndërmarrjet shoqërore dhe ndërmarrjet nën administrimin e Agjensionit Kosovar të Privatizimit;

2.7. ndërmarrjet publike të rregulluara më Ligjin për ndërmarrjet publike ose më një ligj pasardhës.

Neni 7

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese

1. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese:

1.1. do të administrojë me të gjithë pasurinë falimentuese;

1.2. mund të padisë dhe të jetë i paditur në emër të pasurisë falimentuese; dhe

1.3. kryen të gjitha detyrat e specifikuara në këtë ligj për përfaqësuesin e pasurisë falimentuese.

2. Në procedurë të likuidim, Administratori i falimentimit do të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese.

3. Në procedurë të riorganizimit, debitori është përfaqësuesi i pasurisë falimentuese kur vepron si debitori në posedim. Në rastet kur gjykata e emëron një Administrator të falimentimit, Administratori duhet të jetë përfaqësuesi i pasurisë falimentuese në riorganizim.

Neni 8

Juridiksioni i gjykatës dhe mjetet juridike

1. Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike është kompetente për procedurën dhe shqyrtimin e rastit të falimentimit dhe për të gjitha çështjet e ndërlidhura me këtë ligj.

2. Gjykata përbëhet nga një gjyqtar i vetëm kur procedon një rast të falimentimit.

3. Vetëm një palë e interesuar e cila është palë e prekur ose e dëmtuar nga një vendim i nxjerr nga gjykata kompetente ka të drejtën e ankesës në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, Departamentit për Çështje Ekonomike.

4. Secila palë e interesuar ka të drejtë ankese ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës që kanë të bëjnë me çështjet përfundimtare të administrimit të rastit të falimentimit, në afatin prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

5. Përveç kur Gjykata e Apelit vendos ndryshe, ankesa ndaj një vendimi të Gjykatës kompetente nuk do të ndërpres asnjë veprim procedural të urdhëruar nga Gjykata kompetente.

6. Gjykata e Apelit vendos në afat prej pesëmbdhjetë (15) ditësh lidhur me ankesën.

7. Shfrytëzimi i mjeteve të jashtëzakonshme juridike nuk lejohet.

Neni 9**Zbatueshmëria e Ligjit për Procedurën kontestimore**

Dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore janë të zbatueshme edhe për procedurën e falimentimit, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 10**Administrimi i rastit**

1. Gjykata fillon me administrimin e rastit të falimentimit përmes seancave dëgjimore, të cilat fillojnë të zhvillohen jo më larg se shtatë (7) ditë nga dita e pranimit të njoftimit nga palët.
2. Gjykata thërret seancën dëgjimore kur një palë kërkon që gjykata të marr një aktvendim ose kur një seancë e tillë dëgjimore është e rëndësishme për administrimin e rastit.
3. Nëse një palë pranon një ftesë për seancë dëgjimore nga gjykata dhe nuk e konteston mbajtjen e seancës dëgjimore, kërkesën për masë lehtësuese, ose nuk paraqitet në seancë dëgjimore, konsiderohet se ajo palë është pajtuar me kërkesën për masë lehtësuese të cilën gjykata e ka paraqitur qartazi në ftesën e dërguar asaj pale për seancë dëgjimore.

KAPITULLI II**PROCEDURAT E PËRSHPEJTUARA PËR LEHTËSIRAT NDAJ NDËRMARRJEVE TE
VOGLA DHE TË MESME (NVM) DHE PËR PLANET E PARA-DAKORDUARA****Neni 11****Definimi i NVM-ve**

Për qëllime të këtij ligji, Ndërmarrje e Vogël dhe e Mesme (ne tekstin e mëtejme NVM), konsiderohet shoqëria tregtare e cila ka qarkullimin vjetor deri një milion (1,000,000.00) euro ose ka deri në njezët e pesë (25) punëtor.

Neni 12**Procedura për NVM**

1. Përveç nëse ndryshe parashihet me këtë ligj, në secilin rast kur debitor paraqitet një NVM, ai rast do të trajtohet si rast i riorganizimit.
2. Në secilin rast të NVM-ve, NVM duhet të paraqes planin e riorganizimit brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e inicimit të procedurës së falimentimit.
3. Nëse debitori është një person fizik NVM, atëherë vetëm debitori mund të paraqes planin e riorganizimit. Nëse debitori është një person juridik NVM, vetëm debitori mund të paraqes një plan të riorganizimit në 30 ditët e para pas inicimit të procedurës së falimentimit.
4. Nëse në rastin në të cilin përfshihet debitori NVM nuk konfirmohet plani i riorganizimit brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e inicimit të procedurës falimentimit, gjykata do të pushojë rastin pas kërkesës së një pale të interesuar.

Neni 13

Monitoruesi

1. Në secilin rast ku përfshihet një NVM në cilësi të debitorit falimentues, gjykata emëron një monitorues.
2. Gjkata zgjedh monitoruesin nga radhët e administratorëve falimentues të emëruar në përputhje me këtë ligj.
3. Monitoruesi gëzon të drejtën e kompensimit nga pasuria e falimentimit të debitorit në përputhje me Kapitullin IV të këtij ligji.
4. Pas emërimit, monitoruesi këshillon debitorin në lidhje me rrjedhën e biznesit, perspektivat e biznesit dhe mundësinë e përgatitjes së një plani të riorganizimit i cili do të jetë i pranueshëm për kreditorët.
5. Monitoruesi shqyrton secilin plan të propozuar nga debitori NVM me qëllim të vlerësimit se a ofron plani qëndrueshmëri ekonomike dhe a është i realizueshëm. Shqyrtimi i planit mund të ndodh para ose pasi që debitori ia paraqet planin gjykatës.
6. Nëse debitori planifikon të kërkoj votimin e kreditorëve në lidhje me planin e paraqitur gjykatës, monitoruesi është i obliguar që brenda dhjetë (10) ditëve t'i paraqesë gjykatës raportin që përfshinë opinionin e tij mbi realizueshmërinë e planit.
7. Nëse monitoruesi nuk e dorëzon raportin sipas paragrafit 4 të këtij neni, gjykata konsideron se monitoruesi është pajtuar me planin.

Neni 14

Lehtësirat për NVM

1. Një debitor NVM mund të marrë konfirmimin për planin e tij të riorganizimit pa i plotësuar të gjitha kërkesat nga Kapitulli VI, të këtij Ligji, nëse Gjykata konstaton se të gjitha kushtet janë përmbushur:
 - 1.1. brenda dhjetë (10) ditëve nga inicimi i procedurës së falimentimit, i deponon gjykatës kërkesën me shkrim për zbatim të Kapitullit II të këtij ligji;
 - 1.2. monitoruesi i emëruar sipas këtij Kapitulli ka paraqitur në gjykatë raportin mbi realizueshmërinë e planit dhe raporti i është dorëzuar të gjitha palëve të interesuara para fillimit të procedurës së votimit;
 - 1.3. i është dorëzuar të gjithë kreditorëve të prekur nga plani për votim, dhe plani aprovohet nga:
 - 1.3.1. 75% i të gjitha klasave të kreditorëve të siguruar, dhe
 - 1.3.2. të paktën 33.33% e të gjithë kreditorëve të pasiguruar votojnë në favor të planit;

1.4. gjykata nxjerr konkluzion se plani është i realizueshëm kur:

1.4.1. nëse Monitorusi nuk e ka dorëzuar raportin, atëherë aplikohet neni 13 i këtij Ligji; ose

1.4.2. kur të paktën 50% i të gjithë kreditorëve të pasiguruar të cilët votojnë për planin e pranojnë atë;

1.4.3. në të gjitha rastet tjera, debitori duhet të provojë se plani është i realizueshëm;

1.4.4. ose, kur të gjithë kreditorët e siguruar të cilët votojnë për riorganizim e pranojnë atë;

1.5. debitori ofron prova se plani do t'i paguajë të gjithë kreditorët e prekur jo më pak se sa do të realizonin ata në rast se debitori do të paraqiste kërkesë për likuidim.

Neni 15

Lirimi për NVM-të

Debitori NVM lirohet pas konfirmimit të planit të riorganizimit. Lirimi sipas këtij neni do të ketë efektet e njëjta ndaj kërkesave të kreditorëve ndaj NVM-së sikurse lirimi sipas kapitullit VI të këtij ligji.

Neni 16

Definimi i planit të para-dakorduar

Debitori mund t'i kërkojë kreditorëve të tij lehtësira para fillimi të procedurës së falimentimit. Nëse informatat që i janë dhënë kreditorëve janë të hartuara në përputhje me kërkesat për zbulim të Kapitullit VI të këtij Ligji, atëherë debitori mund të kërkojë aprovimin e planit në përputhje me nenin 17 të këtij Ligji.

Neni 17

Procedura për aprovimin e planit të para-dakorduar

1. Një debitor i cili ka siguruar votat e kreditorëve të tij për një plan të riorganizimit para paraqitjes së kërkesës për falimentim, mundet sipas zgjedhjes së tij të kërkojë menjëherë nga gjykata konfirmimin e planit në seancë dëgjimore. Kërkesa për konfirmim të planit bëhet menjëherë me kërkesë për fillim të procedurës së falimentimit.

2. Nëse debitori paraqet një kërkesë të tillë, gjykata do të mbajë një seancë dëgjimore të shpejtuar në të cilën do të përcaktojë nëse në fazën para fillimit të procedurës, debitori i ka plotësuar kushtet e votimit si dhe kërkesat për zbulim të informatave sipas Kapitullit VI të këtij Ligji.

3. Nëse gjykata përcakton se gjatë procedurës para inicimit të rastit të falimentimit, debitori i ka dhënë informacionin e kërkuar kreditorëve sipas Kapitullit VI të këtij Ligji dhe kushtet janë plotësuar, gjykata menjëherë do të vazhdojë me konfirmimin e planit nëse vërtetohet se janë plotësuar kushtet për konfirmim të planit sipas Kapitullit VI të këtij Ligji.

4. Nëse gjykata vërteton se gjatë procedurës para inicimit të rastit të falimentimit, debitori nuk i ka dhënë informatat e kërkuara sipas Kapitullit VI të këtij Ligji, atëherë gjykata nxjerr aktvendim për refuzimin e konfirmimit të planit të riorganizimit dhe debitori vazhdon me procedurën e falimentimit sikurse të mos kishte ekzistuar fare plani i para-dakorduar.

KAPITULLI III

INICIMI I PROCEDURËS DHE HAPJA E RASTIT

Neni 18

Hapja e rastit

1. Një rast konsiderohet se është hapur kur:

1.1. debitori paraqet një kërkesë për inicim vullnetar të riorganizimit ose likuidimit; ose

1.2. është paraqitur një kërkesë jo-vullnetare kundër debitorit, gjykata ka mbajtur seancën dëgjimore për kërkesën e paraqitur dhe gjykata ka nxjerr aktvendim për pranueshmërinë e kërkesës dhe plotësimin e kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 19

Inicimi vullnetar i rastit nga debitori

1. Për inicim vullnetar të rastit, debitori paraqet kërkesën për riorganizim ose kërkesë për likuidim.

2. Debitori nuk duhet të jetë në situatë të paaftësisë paguese për tu kualifikuar për të qenë debitor sipas këtij ligji.

3. Nëse debitori paraqet një kërkesë për qëllime të papërshtatshme ose me qëllim të mashtrimit ose shkakimit të dëmit ndaj kreditorëve, gjykata mund ti shqiptojë gjobë debitorit ose anëtarëve individual të trupave menaxhues ose qeverisës së debitorit.

4. Konsiderohet se debitori ka paraqitur një kërkesë për qëllime të papërshtatshme ose me qëllim të mashtrimit ose shkakimit të dëmit ndaj kreditorëve sipas paragrafit (3) të këtij neni, nëse debitori:

4.1. paraqet kërkesë pa e dhënë emrin e tij të saktë; ose

4.2. nuk i liston të gjithë emrat e mëparshëm përmes të cilave ka qenë i përfshirë në afarizëm; ose

4.3. nuk e liston një kreditor dhe si rezultat ai kreditor nuk pranon njoftim për inicim të procedurës; ose

4.4. ofron informata të rrejshme në cilëndo fazë të procedurës ose tenton të manipulojë me procedurën në çfarëdo forme.

5. Gjykata do të shqiptoj gjyba debitorit në rastet nga paragrafi 4 i këtij neni, nga pesëqind (500) euro deri në dhjetë mijë (10,000) euro dhe paguhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Neni 20

Rastet jovullnetare të iniciuara nga kreditorët

1. Dy (2) ose më shumë kreditorë mund të paraqesin kërkesë për inicim të rastit ndaj një debitori kur:

1.1. debitori ka dështuar të paguajë të paktën nga një detyrim ndaj secilit kreditor, dhe

1.1.1. secilit detyrim i ka kaluar afati i pagesës prej të paktën nëntëdhjetë (90) ditë; dhe

1.1.2. totali i një detyrimi është të paktën në vlerë prej tremijë (3,000) Euro; dhe

1.1.3. secili detyrim është detyrim pa kushte dhe nuk është në procedurë kontestimore pranë një gjykate ose në procedurë të arbitrazhit.

1.2. debitori përgjithësisht nuk është duke i paguar borxhet pas arritjes së afatit të pagesës, dhe borxhi total i detyrimeve të papaguara ka tejkaluar pesëmijë (5,000) euro.

2. Gjykata duhet që në afatin tre (3) ditor të njoftoj debitorin për paraqitjen e kërkesës për inicim të procedurës së falimentimit. Gjykata gjithashtu duhet të caktoj afatin brenda të cilit debitori duhet të paraqes përgjigjen me shkrim ndaj kërkesës dhe seancën dëgjimore për pranueshmërinë e kërkesës. Të gjitha këto informata gjykata duhet t'i paraqes në njoftimin e dërguar palëve. Gjatë periudhës së ndërmjetme, gjykata lëshon urdhrë drejtuar palëve me qëllim të sigurimit të kërkesave të debitorit dhe kreditorëve. Urdhrat e tillë duhet të kërkojnë dhe provohen si të domosdoshme nga palët.

3. Nëse debitori i përgjigjet kërkesës për inicim të procedurës dhe në përgjigje nuk e kundërshton kërkesën, gjykata në afatin sa më të shpejtë nxjerr aktvendim për pranueshmërinë e kërkesës dhe urdhëron hapjen e rastit.

4. Nëse deri në datën e caktuar për mbajtje të seancës dëgjimore mbi pranueshmërinë e kërkesës për inicim të procedurës së falimentimit:

4.1. debitori nuk është përgjigjur ndaj kërkesës, gjykata menjëherë urdhëron hapjen e rastit.

4.2. nëse debitori ka kundërshtuar kërkesën e kreditorëve, kreditorët e mbajnë barrën e provës për t'i dëshmuar gjykatës se:

4.2.1. detyrimet e debitorit ndaj tyre i kualifikojnë ata si kreditorë të pranueshëm për inicim të procedurës së falimentimit; dhe

4.2.2. debitori përgjithësisht nuk është duke i paguar borxhet pas arritjes së afatit të pagesës.

5. Nëse kreditorët arrijnë ti vërtetojnë gjykatës pretendimet sipas nenit paraparak, gjykata menjëherë do të urdhërojë hapjen e rastit.

6. Nëse gjykata nuk urdhëron hapjen e rastit pas kërkesës së kreditorëve për inicim të procedurës së falimentimit dhe gjykata pasi që konstaton se kreditorët ose njëri prej kreditorëve kanë dorëzuar kërkesë me keqbesim ose për qëllime të papërshtatshme, gjykata i urdhëron kreditorët që në mënyrë solidare t'i kompensojnë dëmet dhe humbjet e shkaktuara debitorit. Gjykata ne arsyetimin e aktvendimit konstaton arsyet e mos-hapjes së rastit dhe udhërin eventuale për kompensim. Me qëllim të interpretimit të këtij paragrafi, qëllimi i kreditorëve për të siguruar një pagesë ndaj kërkesës së tyre nuk mund të konsiderohet qëllim i papërshtatshëm ose veprim i tyre me keqbesim.

Neni 21

Refuzimi i kërkesës

1. Gjykata e hedh poshtë si të palejueshme kërkesën për inicim të procedurës së falimentimit nëse:

1.1. gjykata nuk ka kompetencë;

1.2. debitori nuk është i përshtatshëm për të qenë debitor sipas këtij ligji;

1.3. ndaj debitorit veç se është duke u zhvilluar një procedurë e falimentimit;

1.4. entiteti i cili ka paraqitur kërkesën nuk ka zotësi veprimi, përveç në rastet kur kreditorët kanë paraqitur kërkesën dhe kanë mbetur të paktën dy kreditorë me zotësi veprimi; ose

1.5. entiteti i cili ka paraqitur kërkesën nuk i ka paguar taksat gjyqësore dhe nuk është i kualifikuar për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore në përputhje me vendimin e gjykatës ose një vendimi të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Neni 22

Forma e kërkesës dhe regjistrimi i kërkesës

1. Kërkesat për inicim të procedurës së falimentimi sipas këtij Kapitulli mund të jenë në format e nxjerra sipas Kapitullit I të këtij Ligji. Nëse nuk ka forma të tilla, atëherë kërkesa për inicim të procedurës së falimentimit duhet të përmbajë të paktën këto informata:

1.1. emrin e debitorit dhe të gjithë emrat të cilët debitori i ka përdorur në pesë (5) vitet e fundit para inicimit të kërkesës për falimentim;

1.2. të dhënat kontaktuese të debitorit, të cilat minimalisht duhet të përfshijnë adresën, numrin e telefonit, numrin fiskal, numrin e regjistrimit të biznesit, adresën e e-mailit dhe çfarëdo faqe në internet të cilën e ka përdorur debitori nëse ka ekzistuar një e tillë; dhe

1.3. kur debitori është person juridik, të gjitha informatat në dispozicion për zyrtarët, drejtorët, aksionarët, menaxherët ose personat tjerë që gëzojnë kontroll ose pozita menaxheriale ndaj pronave të debitorit, së bashku me informatat kontaktuese për secilin prej tyre në përputhje me nën-paragrafin paraparak.

2. Kërkesat e paraqitura nga kreditorët duhet të përfshijnë sa më shumë informata për debitorin që kreditorët kanë në dispozicion, por minimalisht duhet të përfshijnë emrin e debitorit dhe informata të mjaftueshme kontaktuese për debitorin me qëllim të dërgimit të njoftimeve nga gjykata.

3. Gjykata duhet të regjistroj kërkesën për inicim të procedurës së falimentimit menjëherë pas dorëzimit të saj nga palët. Gjykata bënë regjistrimin e kërkesës pa marrë parasysh të metave të saj. Gjatë regjistrimit duhet të shënohet qartë data dhe koha e pranimit të kërkesës.

4. Gjykata e njofton menjëherë regjistrin e bizneseve, regjistrin e pengut, bankat komerciale, regjistrin e kredive të Bankës Qendrore dhe administratën tatimore për iniciimin e procedurës së falimentimit.

Neni 23

Trajtimi i rasteve ku përfshihen entitetet e ndërlidhura -Konsolidimi

1. Gjykata urdhëron administrim të përbashkët të rasteve, në rastet kur dy ose më shumë kërkesa janë paraqitur në gjykatë nga ose ndaj:

1.1. burrit dhe gruas;

1.2. ortakërisë së përgjithshme ose ortakërisë së kufizuar dhe një ose më shumë ortakëve të përgjithshëm në to; ose

1.3. dy ose më shumë ortakëve të përgjithshëm; ose

1.4. një debitori dhe një entiteti të ndërlidhur.

2. Aktvendimi i gjykatës për administrimin e përbashkët mund të përfshijë çfarëdo dispozite që gjykata e sheh të arsyeshme për të siguruar administrim efektiv të procedurës së falimentimit, dispozita që parashohin mbajtjen e seancave dëgjimore të përbashkëta, agjenda të përbashkëta për administrim të rastit, njoftime të përbashkëta dhe çfarëdo që gjykata sheh të arsyeshme për të zvogëluar kostot dhe vonesat.

3. Para nxjerrjes së aktvendimit për administrim të përbashkët të rasteve, gjykata duhet t'i shqyrtojë mënyrat e mbrojtjes së kreditorëve të pasurive të ndryshme të falimentimit nga konflikti i mundshëm i interesave.

Neni 24

Taksa gjyqësore

Entiteti i cili paraqet kërkesën për inicim të procedurës në gjykatë duhet të paguajë menjëherë taksën gjyqësore të cilën duhet t'ia dorëzoj zyrtarit të gjykatës. Nëse entiteti nuk ofron dëshmi për pagesën e kryer ose nuk ofron dëshmi për lirim nga pagesa, Gjykata do të veprojë në përputhje me ligjet në fuqi.

KAPITULLI IV PASOJAT JURIDIKE TË HAPJES SË RASTIT

Neni 25 Pasoja juridike të hapjes së rastit

1. Hapja e rastit:

- 1.1. e krijon pasurinë e falimentimit;
- 1.2. i jep gjykatës juridiksion ekskluziv për pasurinë e falimentimit dhe mbi debitorin;
- 1.3. vendos moratoriumin, sipas dispozitave të nenit vijues;
- 1.4. në procedurë të likuidimit, shkarkon tërësisht debitorin nga kontrolli i pronave të tij;
- 1.5. në procedurë të riorganizimit në të cilën nuk është i emëruar dhe nuk kërkohet administratori, i jep debitorit të gjitha të drejtat dhe detyrimet e debitorit në posedim; dhe
- 1.6. në procedurë të riorganizimit në të cilën është i emëruar administratori, e shkarkon tërësisht debitorin nga kontrolli i pronave të tij dhe e ngarkon administratorin me kontroll të plotë të atyre pronave.

2. Me hapjen e rastit, gjykata do të:

- 2.1. njoftojë brenda dy (2) ditëve regjistrin e bizneseve, regjistrin e pengut, bankat komerciale, regjistrin e kredive të Bankës Qendrore dhe administratën tatimore për hapjen e rastit. Forma e njoftimit duhet të jetë me shkrim. Pas pranimit të njoftimit nga gjykata, regjistri i bizneseve, regjistri i pengut, bankat komerciale, regjistri i kredive dhe administrata tatimore do të shënojnë në regjistrat e tyre fillimin e procedurës së falimentimit;
- 2.2. shpallet njoftimi në tabelën e shpalljes të Gjykatës dhe në më se paku dy (2) gazeta ditore.
- 2.3. cakton Administratorin sipas dispozitave të këtij ligji, në rast të fillimit të procedurës së likuidimit;
- 2.4. vendos kohën, datën dhe vendin e takimit të parë të kreditorëve, më së largu pesëmbëdhjetë (15) ditë pas hapjes së rastit;
- 2.5. njofton palët për caktim të administratorit dhe do të caktoj datën, kohën dhe vendin e takimit të parë të administratorit me kreditorët.

3. Gjkata cakton një seancë dëgjimore preliminare dhjetë (10) ditë pas caktimit të takimit të parë të kreditorëve për të përcaktuar gjendjen dhe rezultatet e takimit të kreditorëve. Gjkata urdhëron prezencën e debitorit ose përfaqësuesit të tij në këtë seancë dëgjimore.

Neni 26**Moratoriumi dhe ndërprerja e të gjitha veprimeve kundër debitorit**

1. Përveç në rastet kur parashihet ndryshe në këtë ligj, një kërkesë për inicim të procedurës së falimentimit e iniciuar sipas Kapitullit III të këtij ligji vendos ndaj të gjitha entiteteve, moratoriumin dhe urdhër ndalesë pa paralajmërim në lidhje me:

1.1. fillimin ose vazhdimin e çfarëdo veprimi gjyqësor, administrativ ose çfarëdo veprimi ose procedure të drejtuar kundër aktiviteteve afariste të debitorit ose pronave të tij duke përfshirë çfarëdo bllokimi të llogarive bankare dhe veprimeve të cilat janë iniciuar ose do të mund të inicioheshin para inicimit të procedurës së falimentimit;

1.2. përmbarinin ndaj debitorit dhe pronave të tij të çfarëdo aktgjykimi të nxjerr para inicimit të procedurës së falimentimit ose hapjes së rastit, përderisa përmbarimi i tillë është i ndërlidhur me aktivitetet afariste të debitorit;

1.3. çfarëdo veprimi me qëllim të marrjes në posedim ose me qëllim të ushtrimit të kontrollit ndaj pronave pjesë të pasurisë së falimentimit;

1.4. çfarëdo veprimi me qëllim të krijimit, regjistrimit ose përmbarimit të një barre ndaj pronave pjesë të pasurisë së falimentimit;

1.5. çfarëdo veprimi me qëllim të krijimit, regjistrimit ose përmbarimit të një barre, deri në masën që ajo barrë ndërlidhet me aktivitetet afariste të debitorit dhe deri në masën që ajo barrë siguron një kërkesë që ka lindur para inicimit të procedurës së falimentimit;

1.6. çfarëdo veprimi me qëllim të mbledhjes, vlerësimit ose rimarrjes së një kërkesë ndaj debitorit, deri në masën që veprimi ndërlidhet me aktivitetin afarist të debitorit dhe deri në masën që ajo kërkesë ka lidhur para inicimit të procedurës së falimentimit; dhe

1.7. çfarëdo kërkesë për shlyerje të detyrimit drejtuar debitorit, të ndërlidhur me aktivitetin afarist të debitorit, kërkesë e paraqitur para inicimit të procedurës së falimentimit.

Neni 27**Përgjashtimet nga moratoriumi**

1. Inicimi i procedurës së falimentimit sipas këtij ligji nuk vendos moratorium dhe urdhër ndalesën pa paralajmërim ndaj:

1.1. inicimit ose vazhdimin të çfarëdo procedure penale ndaj debitorit;

1.2. inicimit ose vazhdimin të çfarëdo veprimi ose procedure ndaj debitorit si person fizik në çështje familjare ose statusore, përfshirë por pa u kufizuar në procedura të divorcit përveç kur në procedurë të divorcit kërkohet ndarja e pronave të përdorura në aktivitete afarise për përmbushjen e ndonjë kërkesë, kujdestarisë, alimentacionit, vërtetimit të atësisë ose amësisë;

1.3. procedurave të ndërlidhura me shkeljet e ligjeve për mbrojtjet mjedisore, shëndetin ose sigurinë;

1.4. auditimit ose kontrollit financiar nga administrata tatimore për të përcaktuar por jo përmbaruar borxhin tatimor;

1.5. veprimet ose procedurat e iniciuara kundër palëve të tretat të cilat ndërlidhet ndaj çfarëdo kërkesë kundër debitorit, duke përfshirë por mos u kufizuar në veprimet kundër çfarëdo entiteti i cili ka garantuar ndonjë kërkesë kundër debitorit, pronave të debitorit ose kundër një ortaku të përgjithshëm të debitorit i cili është ortakëri e përgjithshme ose ortakëri e kufizuar;

1.6. paraqitja dhe dhënia e njoftimit por jo pagesa e një instrumenti të negociushëm dhe paraqitja e kundërshtimit për një instrument të tillë.

Neni 28

Kohëzgjatja e kufizuar

1. Moratoriumi sipas këtij Ligji është në fuqi për njëqind e njëzet (120) ditë prej momentit të hapjes së rastit, ose deri në momentin kur debitori pranon një lirim, përveq nëse ndryshe parashihet në këtë Ligj, ose nëse moratoriumi vazhdohet sipas këtij Ligji.

2. Moratoriaumi mund të vazhdohet edhe pas njëqind e njëzet (120) ditëve, nëse gjykata e vërteton se përfaqësuesi i pasurisë falimentuese ka ofruar prova të mjaftueshme se vazhdimi i moratoriumit do të kontribuonte në realizimin e qëllimeve sipas këtij ligji. Në asnjë rast moratoriumi nuk mund të vlej më shumë se një 1 vit nga dita e hapjes së rastit.

3. Gjatë kohëzgjatjes së moratoriumit sipas këtij ligji, të gjitha afatet ligjore për të gjitha veprimet juridike kundër debitorit të cilat janë të ndaluara me moratorium, do të suspendohen. Vazhdimi i afateve fillon në momentin kur moratoriumi nuk është më i vlefshëm.

Neni 29

Ndërprerja ose ndryshimi i moratoriumit

1. Në bazë të kërkesës së një pale të interesuar, gjykata ndërpret, ndryshon, kushtëzon, anulon ose amendamenton moratoriumin e vendosur sipas këtij ligji para skadimit të tij, nën kushtet si vijon:

1.1. në rastet kur debitori dështon t'i ofrojë siguri për ruajtjen e vlerës kreditorit dhe kreditori dëshmon se kërkesa për ruajtje të vlerës së barrës së tij ishte e vlefshme dhe e arsyeshme;

1.2. kreditori dëshmon se vlera e siguruar me barrë e tejkalon vlerën e pronës ndaj të cilës kreditori ka barrën, dhe se:

1.2.1. rasti është rast për likuidim; ose

1.2.2. përfaqësuesi i pasurisë falimentuese dështon t'i vërtetojë gjykatës se prona ndaj të cilës ekziston barra është pronë e rëndësishme për realizimin efektiv të riorganizimit sipas këtij ligji.

2. Në bazë të kërkesës së një pale të interesuar, gjykata, me ose pa seancë dëgjimore mund të lejojë një lirim nga moratoriumi i vendosur sipas këtij ligji, nëse është e nevojshme për të

parandaluar dëmet e mundshme të pariparueshme që mund t'i shkaktohen një entiteti ndaj asaj prone, nëse interesat do të mund të dëmtoheshin para se të ekzistojë mundësia për njoftim ose mbajtje të seancës dëgjimore sipas këtij neni.

Neni 30

Detyrimet e debitorit

Krahas kërkesave të parapara në këtë ligj për bashkëpunim dhe shpalosje sipas nenit 32 të këtij ligji, debitori ka për detyrë thelbësore veprimin me mirëbesim dhe shpalosjen e plotë gjatë veprimeve të tij në përputhje me këtë ligj. Debitorit nuk i lejohet t'i ofroj gjykatës ose kreditorëve informata që janë të rreme ose mashtruese, ose të refuzojë të jap një informatë e cila nëse nuk jepet nga debitori mund të sjell gjykatën dhe kreditorët në lajthim, mashtrim ose pasaktësi të informacionit.

Neni 31

Paraqitja e informatave

1. Kur debitori paraqet kërkesë për inicim të procedurës së falimentimit, duhet të paraqes edhe:

1.1. listën e të gjithë kreditorëve për të cilët ai ka njohuri se ekzistojnë, së bashku me informatat kontaktuese për secilin prej tyre;

1.2. listën e të gjitha kërkesave ndaj debitorit për të cilat ai ka njohuri se ekzistojnë, së bashku me vlerën e secilës kërkesë, datën e përafërt kur janë shfaqur kërkesat dhe informacionin nëse kërkesa është e kontestuar, e mundshme ose e pamaturuar;

1.3. listën e të gjitha aseteve të debitorit, së bashku me një vlerësim të përgatitur me mirëbesim në lidhje me vlerën e atyre aseteve. Nëse një aset është i prekshëm, debitori duhet të jap lokacionin se ku gjendet ai aset; nëse aset i paprekshëm atëherë debitori duhet të jap informacion se kush është personi i detyruar ndaj asetit të paprekshëm dhe informatat kontaktuese të tij;

1.4. listën e të gjithë transaksioneve jashtë rrjedhës normale të biznesit të debitorit, në të cilat debitori ka qenë palë ose përfitues, të realizuara gjatë dy viteve të fundit llogaritur prej ditës në të cilën është paraqitur kërkesa për inicim të procedurës së falimentimit. Debitori gjithashtu duhet të paraqes datat e këtyre transaksioneve dhe të jap informatat kontaktuese të palëve në këto transaksione (së bashku me informatën nëse ndonjëra nga këto palë konsiderohet person i brendshëm sipas këtij ligji); dhe

1.5. listën e të gjitha transaksioneve, vlera e të cilave ka qenë më shumë se nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë (999) Euro, në të cilat debitori ka qenë palë ose përfitues, të realizuara gjatë një viti llogaritur nga dita në të cilën debitori ka paraqitur kërkesën për inicim të procedurës së falimentimit. Debitori duhet të paraqes datën e secilit transaksion, identitetin dhe informatat kontaktuese të secilës palë në këto transaksione së bashku me informatën nëse ndonjëra nga këto palë konsiderohet person i brendshëm sipas këtij ligji.

2. Nëse kërkesa për inicim të procedurës së falimentimit paraqitet nga kreditorët, kreditorët duhet të paraqesin sa më shumë informata që kanë në posedim ose që mund t'i sigurojnë në përputhje me paragrafin paraprak të këtij neni.

3. Nëse kërkesa e kreditorëve për hapje të rastit të falimentimit pranohet nga Gjykata, debitori e ka për obligim që brenda afatit 10 ditor nga hapja e rastit t'i ofrojë Gjykatës të gjitha informatat sipas paragrafit 1 të këtij neni.

4. Në rast të ekzistimit të rrethanave të arsyeshme, gjykata mund të zgjas afatin e paraparë në paragrafin 3 të këtij neni edhe për 10 ditë tjera.

5. Të gjitha listat dhe informatat e kërkuara sipas këtij neni do të jenë të hapura për publikun, por gjykata sipas kërkesës së palës vendos që informatat e tilla të mbyllën për publikun. Në rast të ekzistimit të një kërkesë të tillë, debitori duhet të provojë se informatat e tilla:

5.1. përbëjnë sekret tregtar ose informacion tjetër konfidencial hulumtues, zhvillimor ose komercial i cili në rastin kur bëhet i ditur për publikun mund të reduktojë vlerën e pronave të pasurisë falimentuese;

5.2. përbëjnë skandal ose shpifje;

5.3. duhet të mbahen sekrete sipas një ligji të aplikueshëm.

Neni 32

Bashkëpunimi

Debitori është i detyruar të bashkëpunojë me Administratorin në të gjitha çështjet dhe do ti ofroj administratorit qasje pa vonesë në të gjitha dokumentet dhe informatat që kanë të bëjnë me aktivitetin dhe resurset e debitorit, duke përfshirë të gjithë informacionin për kërkesat, pronat dhe transaksionet e shpalosura sipas nenit paraprak.

Neni 33

Shitja dhe përdorimi i aseteve

1. Përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit nuk mund të kryej asnjë transfer për të realizuar një kërkesë e cila ka lindur para inicimit të procedurës së falimentimit, përveç në rastet kur një gjë e tillë është e lejuar me këtë ligj ose e autorizuar nga gjykata.

2. Sipas kushteve të paragrafit 1 të këtij neni, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të shes, përdor ose lëshoj me qira pronën e cila është pjesë e pasurisë falimentuese gjatë rrjedhës normale të biznesit, nëse shitja, përdorimi ose lëshimi me qira i asaj prone është pjesë e rrjedhës normale të biznesit, pa pasur nevojë të kërkojë aprovim nga gjykata.

3. Me aprovim të gjykatës, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të shes, të vejë në përdorim ose të lëshoj me qira një pronë e cila është pjesë e pasurisë falimentuese.

4. Nën kushtet e parapara në këtë paragraf, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të shes, përdoroj ose lëshoj me qira një pronë në të cilën një entitet tjetër nga debitori ka interes:

4.1. çfarëdo shitje e pronës e cila është pjesë e pasurisë falimentuese në të cilën një entitet tjetër nga debitori ka interesa është e kushtëzuar me ofrimin e provave se përfaqësuesi i pasurisë falimentuese ka siguruar ruajtjen e vlerës ndaj atij jo-debitori;

4.2. përveç kur gjykata urdhëron ndryshe, nëse përfaqësuesi i pasurisë falimentuese propozon shitjen e pronës pjesë e pasurisë falimentuese në të cilën një entitet ka një barrë, përfaqësuesi duhet t'i jap mundësinë entitetit që e ka atë barrë që të ofrojë blerjen e asaj prone. Në rastet kur entiteti vendos për blerjen e pronës ndaj të cilës ka një barrë, entiteti mund të kompensojë çmimin e blerjes me barrën me qëllim të përmbushjes së kërkesave.

5. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të shes një pronë nga pasuria dhe blerësi ta blejë atë pronë pa asnjë ngarkesë ose interes mbi atë pronë, vetëm nëse përfaqësuesi i pasurisë falimentuese provon se:

5.1. legjislacioni në fuqi e lejon shitjen e asaj prone pa ndonjë ngarkesë;

5.2. entiteti e jep pajtimin;

5.3. në rast të ekzistimit të një barre, barra mbetet e vlefshme edhe pas shitjes së pronës; ose

5.4. interesi specifik është në shqyrtim në procedurë kontestimore.

Neni 34

Financimi i pasurisë falimentuese pas inicimit të rastit

1. Përveç në rastet kur gjykata vendos ndryshe, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të marrë kredi të pasiguruar dhe të krijojë detyrime të pasiguruara gjatë rrjedhës normale të afarizimit të tij, e cila është e lejueshme si shpenzim administrativ.

2. Gjkata autorizon përfaqësuesin e pasurisë falimentuese për të marrë kredi të pasiguruar ose krijuar detyrime të pasiguruara shtesë ndaj atyre të lejuara në paragrafin 1 të këtij neni, e cila gjithashtu është e lejueshme si shpenzim administrativ.

3. Nëse përfaqësuesi i pasurisë falimentuese e ka të pamundshme të marrë kredi të pasiguruar të lejueshme si shpenzim administrativ, gjykata mund të autorizojë marrjen e kredisë ose mund të lejojë hyrjen në detyrime si shpenzim administrativ:

3.1. me prioritet ndaj cilitdo ose të gjitha shpenzimeve administrative;

3.2. të siguruar me një barrë ndaj një prone pjesë të pasurisë falimentuese e cila nuk është paraprakisht e ngarkuar me ndonjë barrë; ose

3.3. të siguruar me një barrë ndaj një prone pjesë të pasurisë falimentuese e cila është paraprakisht e siguruar me barrë, me kushtin që barra e re të mos ketë prioritet ndaj barrës ekzistuese.

4. Çfarëdo financimi i ri i cili është lejuar në përputhje me këtë nen nuk mund të deklarohet i pavlefshëm ose i paekzekutueshëm nga kreditorët ose trupa përfaqësuese e kreditorëve në asnjë mënyrë ose kohë.

Neni 35**Kontratat ende të papërbushura nga të dy palët**

1. Kontratat e papërbushura të cilave ju referohet ky nen janë ato kontrata të debitorit të cilat në momentin e hapjes së rastit nuk janë përbushur nga të dy palët, debitori dhe jo-debitori dhe se mospërbushja e të cilave do të konsiderohej shkelje sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

2. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese pranon, refuzon ose transferon kontratat e papërbushura.

3. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese duhet të marrë aprovim nga gjykata për secilin vendim të tij për të pranuar, refuzuar ose transferuar kontratat e papërbushura. Gjkata aprovon vendimin e përfaqësuesit të pasurisë falimentuese në rastet kur përfaqësuesi i dëshmon gjykatës së vendimi është marrë duke ushtruar funksionet e tij me mirëbesim dhe gjykim të drejtë afarist, dhe të gjitha kërkesat nga ky nen janë plotësuar.

4. Nëse përfaqësuesi i pasurisë falimentuese:

4.1. pranon një kontratë të papërbushur, atëherë pasuria falimentuese bëhet përgjegjëse për të gjitha obligimet e përbushjes së kontratës dhe çfarëdo detyrimi i cili mund të lind si rezultat i asaj kontrate konsiderohet shpenzim administrativ;

4.2. refuzon ose transferon një kontratë të papërbushur, atëherë pasuria falimentuese nuk do të ketë asnjë përgjegjësi në të ardhmen për obligimet nga ajo kontratë dhe çfarëdo detyrimi që mund të ketë lindur nga ajo kontratë trajtohet si të ketë lindur menjëherë para inicimit të procedurës së falimentimit. Refuzimi konsiderohet vetëm shkelje e kontratës së papërbushur; nuk e shfuqizon ose nuk e bën atë të pavlefshme.

5. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të pranojë një kontratë të papërbushur në të cilin debitori ka qenë në shkelje të detyrimit, vetëm nëse:

5.1. përfaqësuesi e mënjanon shkeljen duke zbatuar detyrimin;

5.2. e kompenson jo-debitorin për çfarëdo dëmi që mund t'i ketë shkaktuar si rezultat i shkeljes; dhe

5.3. ofrojnë siguri të mjaftueshme për përbushje të detyrimit gjatë përbushjes së kontratës në të ardhmen.

6. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk mund të pranojë një kontratë nëse:

6.1. në kontratë ka qenë një obligim ose një premtim për të marrë një hua ose instrument tjetër financiar;

6.2. një ligj i aplikueshëm e lejon palën jo-debitor që të mos pranojë përbushjen e kontratës nga një entitet që nuk është debitori dhe jo-debitori nuk pajtohet për marrjen e obligimit për përbushje.

7. Cilado dispozitë në kontratën e papërbushur ose në një ligj të aplikueshëm parasheh se

pala kontraktuese jo-debitor mund të ndërprejë ose ndryshojë kontratën nën kushtet që:

7.1. debitori është në situatë jo të mirë financiare ose në falimentim; ose

7.2. iniciimi i procedurës së falimentimit sipas këtij ligji nuk do të ketë efekt ndaj pasurisë falimentuese ose përfaqësuesit të saj.

8. Cila do dispozitë në kontratën e papërbushur ose në një ligj të aplikueshëm ndalon, kufizon ose kushtëzon debitorin në përbushje të kontratës nuk do të ketë asnjë efekt ndaj përfaqësuesit të pasurisë së falimentimit.

9. Nëse kontrata e papërbushur ka për objekt qiradhënien e një prone të paluajtshme ose licencën e një prone të paprekshme, dhe debitori është qiradhënësi ose bartësi i licencës, atëherë jo-debitorit edhe nëse i refuzohet kontrata do të ketë mundësinë të vendos për të vazhduar përdorimin e objektit të kontratës ose mbajtjen e posedimit të objektit të kontratës.

10. Vazhdimi i përdorimit të objektit të kontratës ose posedimi i tij kushtëzohet me pagesën e çmimit të kontraktuar për përdorim të objektit të kontratës (pagesa e qirasë ose licencës).

11. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk ka për detyrim të përbush asnjë obligim të papërbushur nga kontrata e refuzuar ndërsa jo-debitori do të mbajë përgjegjësi për kompensimin e çfarëdo dëmi që mund të lind si rezultat i refuzimit të tij për të përbushur obligimet nga kontrata.

12. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese vendos për pranimin ose refuzimin e një kontrate të papërbushur në afatin më të hershëm pas konfirmimit të planit të riorganizimit deri në afatin më të vonshëm që është koha para mbylljes së rastit.

Neni 36

Braktisja e pronave me ngarkesë të madhe për pasurinë falimentuese

1. Në bazë të kërkesës së përfaqësuesit të pasurisë falimentuese, gjykata e lejon përfaqësuesin të braktisë një pronë me ngarkesë të madhe për pasurinë falimentuese, dhe t'ia lë një pale të interesuar.

2. Në bazë të kërkesës së një pale të interesuar, gjykata urdhëron përfaqësuesin e pasurisë së falimentimit të braktisë cilëndo pronë me ngarkesë të madhe për pasurinë falimentuese.

3. Përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe, prona e listuar nga debitori sipas Kapitullit IV të këtij ligji dhe e cila nuk është duke u administruar gjatë kohës së mbylljes së rastit konsiderohet e braktisur dhe e lënë debitorit.

4. Përveç kur gjykata vendos ndryshe, prona e cila nuk është e braktisur sipas dispozitave të këtij neni dhe e cila nuk është e lënë në qarkullim sipas ndonjë dispozite tjetër të këtij ligji konsiderohet pronë e pasurisë falimentuese.

Neni 37**Anulimi i bartjeve transfereve të caktuara**

Përfaqësuesi i pasurisë të falimentimit ka kompetencë të anulojë transaksionet e realizuara dhe të kthejë pronat e transferuara para inicimit të procedurës së falimentimit në përputhje me dispozitat e neneve 38,39,40,41,42,43,44 të këtij ligji. Për qëllim të këtij ligji, anulimi i bartjeve të caktuara nënkupton mënjanimin ose anulimin e transaksioneve të cilat retroaktivisht shpallen pa efekte juridike dhe përfituesi i transferit konsiderohet se nuk ka pranuar asgjë nga debitori.

Neni 38**Marrja e pasurisë**

1. Përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit ka kompetencë të kthejë përmes veprimit ose të kërkojë dhe pranojë kthimin e cilësdo pronë, pjesë e pasurisë së falimentimit e cila është duke u mbajtur nga një entitet tjetër nga debitori në momentin e fillimit të procedurës së falimentimit.

2. Cilido entitet i cili posedon ose kontrollon një pronë, pjesë të pasurisë së falimentimit duhet t'i dorëzojë përfaqësuesit të pasurisë së falimentimit atë pronë ose kundërvlerën e plotë të asaj prone, sipas zgjedhjes së përfaqësuesit të pasurisë falimentuese, me kushtin e mbrojtjes së vlerës nga përfaqësuesi i pasurisë.

3. Cilido entitet i cili ka një detyrim që është pronë, pjesë e pasurisë falimentuese dhe ai detyrim është maturuar ose është bërë i pagueshëm, duhet që menjëherë pas kërkesës ta paguajë në tërësi detyrimin të përfaqësuesi i pasurisë falimentuese.

Neni 39**Preferencat**

1. Përveç në rastet e parapara në paragrafin 3 të këtij neni, përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit mund të anulojë një transfer bartje nëse:

1.1. bartja ka ndodhur para fillimit të procedurës së falimentimit;

1.2. bartja i është bërë kreditorit ose është bërë për përfitim të kreditorit ku pagesa ka pasur efektin e zvogëlimit të ekspozimit ndaj një garancioni për llogari të borxhit i cili është mbledhur para bartjes;

1.3. bartja është bërë kur debitori ka qenë josolvent;

1.4. bartja është bërë deri në njëqind e njëzet (120) ditë para inicimit të procedurës së falimentimit, ndërsa në rastet kur përfituesi i transferit është person i brendshëm bartja është bërë deri në treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë para inicimit të procedurës së falimentimit; dhe

1.5. bartja i ka mundësuar përfituesit të transferit të pranojë më shumë nga debitori dhe pasuria e falimentimit, se sa që do të kishte pranuar në rastet kur të iniciohej procedura e likuidimit dhe ai do të kishte marrë dividendën e tij nga pasuria e likuiduar.

2. Bartja nuk kualifikohet sipas paragrafit 1 nën-paragrafit 1.5 të këtij neni, nëse bartja i është bërë:

2.1. një kreditori të siguruar gjatë kohës kur vlera e kolateralit të kreditorit ka qenë më e madhe se shumta e kërkesës së siguruar të kreditorit;

2.2. një kreditori me kërkesë të siguruar, kolaterali i të cilit ka vlerë më të vogël se të gjitha kërkesat e tij, por vetëm deri në masën që vlera e bartjes tejkalon vlerën e diferencës në mes të vlerës së të gjitha kërkesave të kreditorit dhe vlerës së kolateralit të kreditorit; dhe

2.3. një kreditori me prioritet në pagesa ndaj kreditorëve të pasiguruar, përderisa pasuria e falimentimit nuk është në situatë të pa-aftësisë pagueuse të shpenzimeve administrative.

3. Kreditori gëzon mbrojtje të plotë ndaj një veprimi për anulim të bartjes sipas paragrafit 1 të këtij neni, përderisa:

3.1. bartja është si rezultat i rrjedhës normale të biznesit të debitorit;

3.2. bartja është barra dhe barra është dhënë për t'i mundësuar debitorit blerjen e pronës të ngarkuar me atë barrë; ose

3.3. bartja është bërë si rezultat i urdhrat të gjykatës për pagesë të alimentacionit ose kompensimit të viktimave të dhunës.

4. Për qëllime të këtij neni:

4.1. debitori konsiderohet se ka qenë në pa-aftësi pagueuse gjatë njëqind e njëzet (120) ditëve para inicimit të procedurës së falimentimit;

4.2. përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit duhet të provojë ekzistimin e të gjithë elementeve të parapara në paragrafin 1 të këtij neni.

5. Kreditori duhet të provojë të drejtën e tij për të gëzuar mbrojtje sipas paragrafit 3 të këtij neni me qëllim të gëzimit të asaj mbrojtje.

Neni 40

Bartjet jo-komerciale dhe për qëllime mashtrimi

1. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të anulojë një bartje ose një obligim të debitorit në rast se:

1.1. bartja është bërë nga debitori me qëllim të fshehjes, pengimit ose mashtrimit të kreditorëve deri 2 vite para inicimit të procedurës së falimentimit;

1.2. bartja është bërë me vlerë më të vogël se vlera e arsyeshme kur:

1.2.1. debitori ka qenë në situatë të pa-aftësisë pagueuse;

1.2.2. nuk ka pasur kapital ose rezerva të mjaftueshme për t'i paguar detyrimet e tij të pritshme; dhe

1.2.3. është bërë deri 2 vite para inicimit të procedurës së falimentimit.

2. Përfituesi i bartjes ose përfituesi i pagesës së një detyrimi që pranon një vlerë dhe që ka një barrë në mirëbesim mund të ruajë një interes të bartur ose mund të përmbarojë çfarëdo obligimi të mbledhur, deri në masën që një bartje ose pagesë e tillë i jep vlerë debitorit në shkëmbim për bartjen ose detyrimin.

3. Për qëllime të këtij neni, "vlerë" nënkupton pronën, përmbushjen ose sigurimin e një borxhi të tanishëm ose të ardhshëm të debitorit, por nuk përfshinë premtimin e papërmbushur për dhënie të mbështetjes debitorit ose një të afërmi të debitorit.

Neni 41

Kërkesat e siguruara me hipotekat jo të plota ose të papërshtatshme

1. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të anulojë një barrë nëse:

1.1. një ligj i aplikueshëm kërkon regjistrimin e një barre në regjistra publik; dhe

1.2. kreditori deri në momentin e inicimit të procedurës së falimentimit nuk e ka kryer obligimin ligjor të regjistrimit të barrës së tillë në regjistra publik.

Neni 42

Statusi i kreditorit përmbarues

Përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit e ka statusin e kreditorit përmbarimor të supozuar nga momenti i inicimit të procedurës së falimentimit, dhe do të ketë prioritetin e supozuar mbi të gjitha barrat ndaj të gjitha kërkesave të të gjithë kreditorëve, në masën e njëjtë që do ta kishte debitori po të mos iniciohej procedura e falimentimit.

Neni 43

Bartjet e pa-autorizuara pas paraqitjes së kërkesës për falimentim

1. Përveç në rastet sipas nënparagrafin 1.2 të këtij neni, përfaqësuesi i pasurisë falimentimit mund të anulojë një bartje të pronës, pjesë të pasurisë së falimentimit:

1.1. e cila ka ndodh pas inicimit të procedurës së falimentimit; dhe

1.2. e cila nuk është e lejuar sipas këtij ligji ose nga gjykata;

1.3. në rastet e inicimit të procedurës së falimentimit nga kreditorët, përfaqësuesi i pasurisë falimentimit nuk mund të anulojë një bartje e cila ka ndodhur pas paraqitjes së kërkesës për inicim të procedurës së falimentimit dhe para hapjes së rastit, përderisa përfituesi i bartjes ka dhënë një vlerë në shkëmbim të bartjes së tillë.

Neni 44

Mbrojtjet e përgjithshme

1. Përderisa një bartje është anuluar në përputhje me këtë ligj, përfaqësuesi i pasurisë se

falimentimit mund të rikthejë pronën e transferuar në pasurinë e falimentimit ose vlerën e asaj prone nëse urdhëron gjykata, nga:

1.1. përfituesit fillestar të bartjes së tillë ose prej entitetit i cili ka përfituar nga bartja e tillë; ose

1.2. cilitdo përfitues i asaj bartjeje, ose kushdo i cili është përfitues titullar i asaj bartjeje, si rezultat i bartjes nga përfituesi fillestar.

2. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk mund të rikthejë pronën sipas nën-paragrafit 1.2 të paragrafit 1 të këtij neni, nga:

2.1. përfituesi i bartjes i cili e ka pranuar vlerën për të përmbushur një borxh të tashëm ose të ardhshëm të debitorit, në mirëbesim, pa pasur njohuri se një bartje e tillë do të mund të anulohet;

2.2. cilitdo përfitues i bartjes nga përfituesi paraparak i bartjes i cili ka vepruar me mirëbesim.

3. Një përfitues i transferit me mirëbesim prej të cilit përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të rikthejë pronën sipas paragrafit 1 të këtij neni, ka një barrë mbi pronën e rikthyer për të siguruar:

3.1. koston për përmirësimet e bëra pas bartjes ndaj përfituesit të transferit, më pak se shuma e ndonjë profiti të realizuar nga përfituesi i transferit prej asaj prone; dhe

3.2. çfarëdo rritje të vlerës të asaj prone si rezultat i përmirësimeve të bëra, të pronës së bartur.

4. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese ka të drejtë vetëm në një realizim sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 45

Shpërblimi i profesionistëve

1. Pas njoftimit të dërguar palëve të interesuara, gjykata ë urdhëron që një profesionisti të punësuar sipas këtij ligji:

1.1. t'i paguhet shpërblimi për shërbimet e ofruara nga profesionisti ose nga një person tjetër i punësuar nga profesionisti; dhe

1.2. t'i rimbursohen shpenzimet reale dhe të nevojshme.

2. Gjkata sipas kërkesës së palës ose sipas vlerësimit të saj, ti ofroj një shpërblim më të vogël profesionistit se sa shpërblimi që është kërkuar nga ai.

3. Gjatë përcaktimit të shumës së shpërblimit për profesionistin, gjykata do të ketë për bazë natyrën e punës, kohëzgjatjen dhe vlerën e shërbimeve të tilla, duke konsideruar të gjithë faktorët, përfshirë:

3.1. kohën e kaluar në ofrimin e atyre shërbimeve;

3.2. tarifat e faturuara për ato shërbime;

3.3. nëse shërbimet e ofruara nga profesionisti kanë qenë të nevojshme dhe përfituese për përfundimin e suksesshëm të procedurës së falimentimit;

3.4. nëse shërbimet janë kryer për një kohë të arsyeshme, duke pas parasysh komplikueshmerinë, rëndësinë dhe natyrën e problemit, çështjes ose punës së trajtuar;

3.5. nëse shpërblimi është i arsyeshëm bazuar në shpërblimet të cilat i kërkojnë profesionistët e ngjashëm gjatë trajtimit të rasteve të ngjashme sipas këtij ligji. Shpërblimi i profesionistëve nuk mund të zvogëlohet me arsyen se kreditorët mund të mos paguhen në tërësi.

4. Gjykata nuk do të lejojë shpërblim për:

4.1. përsëritjen të panevojshëm të shërbimeve të njëjta;

4.2. shërbimet nuk janë për përfitimin e pasurisë falimentuese ose nuk janë të nevojshme për administrimin e rastit.

5. Kur gjykata e aprovon kërkesën e profesionistit për shpërblim dhe për rimbursim të shpenzimeve, të gjitha shumat e paguara profesionistit do të konsiderohen shpenzime administrative.

KAPITULLI V

KËRKESAT E KREDITORËVE

Neni 46

Arritshmëria e të gjitha kërkesave

Kërkesat e pa arritura (pa-maturuara) do të konsiderohen të arritura (maturuara) në momentin kur gjykata vendos për hapjen e rastit të falimentimit.

Neni 47

Definimi i kërkesës së siguruar

1. Një kërkesë konsiderohet kërkesë e siguruar deri në vlerën e kolateralit që siguron pagesën e kërkesës;

2. Nëse kërkesa e kreditorit e tejkalon vlerën e kolateralit që siguron pagesën e kërkesës, konsiderohet se kreditori për pagesën mbi vlerën e kolateralit ka kërkesë të pasiguar.

3. Nëse një palë e interesuar e konteston vlerën e kërkesës së siguruar, gjykata:

3.1. e bënë vlerësimin e kolateralit të kreditorit pas hapjes së rastit;

3.2. e përcakton vlerën e kolateralit në përputhje me qëllimin e vlerësimit të kolateralit dhe natyrën e përdorimit të kolateralit;

3.3. e përcakton vlerën e kolateralit në seancë dëgjimore, ku kreditori i prekur nga vlerësimi mund të jap informata për natyrën e përdorimit të kolateralit ose planin që mund të ndikojë drejtpërdrejtë te kreditori.

Neni 48

Kompensimi i kërkesave

1. Pas inicimit të procedurës së falimentimit, kompensimi i ndërsjellë i kërkesave në mes të debitorit dhe kreditorit lejohet vetëm gjer në shkallën e përcaktuar me këtë nen.

2. Jashtë kompensimit të kërkesave që përfshijnë llogaritë bankare, kreditori mund të kompensojë një kërkesë që ka ndaj debitorit, nëse kërkesa:

2.1. ka ekzistuar brenda gjashtë muajve nga hapja e rastit; dhe

2.2. kreditori i dërgon njoftim me shkrim përfaqësuesit të pasurisë falimentuese para skadimit të afatit të regjistrimit të kërkesave dhe provave mbi ekzistimin e kërkesave.

3. Sa i përket llogarive bankare:

3.1. pas hapjes së rastit, banka nuk mund të kompensojë asnjë detyrim që i ka debitorit ndaj asnjë detyrimi që ka debitori ndaj bankës;

3.2. nëse banka ka bërë kompensimin ndaj bilancit në llogarinë bankare të debitorit për borxhet e debitorit ndaj saj gjashtë (6) muaj para hapjes së rastit falimentues, banka detyrohet ti kthejë pasurisë falimentuese diferencën në mes të:

3.2.1. deficitit që ka ekzistuar gjashtë (6) muaj para hapjes së rastit shumë e detyruar ndaj bankës që ka tejkualuar vlerën e bilancit atë kohë; dhe

3.2.2. deficitin e kalkuluar sipas nën-paragrafit paraprak menjëherë pas kryerjes së kompensimit.

4. Kërkesat që janë paraqitur para datës së hapjes së rastit nuk do të kompensohen kundër kërkesave që janë paraqitur pas datës së hapjes së rastit.

Neni 49

Obligimi i kreditorëve për të ofruar dëshmi mbi kërkesën

1. Secili kreditor duhet ta regjistrojë kërkesën dhe provat mbi ekzistimin e kërkesë në gjykatë, me qëllim të vërtetimit të vlefshmërisë dhe vlerës së kërkesës.

2. Gjykata i ofron palëve një formë specifike për regjistrimin e kërkesës dhe provave për ekzistimin e kërkesës. Në mungesë të një forme specifike, kreditorët do të deponojnë në gjykatë një deklaratë me shkrim e cila konsiderohet deklaratë nën betim që:

- 2.1. përshkruan kërkesën, duke përfshirë informatën se a është kërkesa e pasiguruar, me prioritet ose e siguruar;
 - 2.2. përcakton vlerën e kërkesës deri në ditën e hapjes së rastit të falimentimit;
 - 2.3. t'i bashkëngjis kopjet e sakta dhe të plota të dokumentacionit përcjellës në lidhje me atë kërkesë ose barrë që lidhet me atë kërkesë, nëse këto janë të aplikueshme.
3. Nëse kreditori nuk bashkëngjit prova mbi ekzistimin e kërkesës, ai nuk do të mund:
- 3.1. të marrë pjesë në shpërndarjen e pasurisë falimentuese në favor të kreditorëve;
 - 3.2. të marrë pjesë në komitetet e kreditorëve;
 - 3.3. të votojë për planin e riorganizimit.
4. Në procedurë të likuidimit, kreditori duhet të regjistrojë kërkesën sipas këtij neni në afatin prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për hapjen e procedurës së falimentimit.
5. Në një procedurë të riorganizimit, përveç kur gjykata urdhëron ndryshe për shkak të nevojave të procedurës së riorganizimit, kreditori duhet të regjistrojë kërkesën brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për hapjen e procedurës së falimentimit.
6. Deri në tridhjetë (30) ditë pas kalimit të afateve të parapara në paragrafët 4 dhe 5, të këtij neni përfaqësuesi i pasurisë falimentuese e regjistron dëshminë për ekzistimin e kërkesave në emër të cilitdo kreditor, duke vepruar me mirëbesim.
7. Regjistri i kërkesave është i hapur për publikun gjatë orarit të rregullt të punës së gjykatave dhe gjykata lejon përmes procedurave të arsyeshme, inspektimin, fotokopjimin dhe çasjen e atyre të dhënave nga publiku.

Neni 50

Procedura ndaj kërkesave

1. Provat për kërkesën të regjistruara në përputhje me këtë ligj konsiderohen provat që supozojnë vlefshmërinë dhe vlerën e kërkesës së kreditorit dhe të barrës mbi atë kërkesë. Nëse nuk ka ndonjë kundërshtim të kërkesës, kreditori nuk ka nevojë të ndërmarr veprime shtesë dhe kërkesa do të konsiderohet e lejueshme.
2. Pala e interesuar mund t'i kundërshtoj provat e regjistruara me kërkesën.
3. Nëse pala e interesuar i kundërshton provat mbi kërkesën, gjykata vendos për vlefshmërinë dhe vlerën monetare të kërkesës në Euro sipas ligjeve të aplikueshme, aq sa ka qenë në ditën e hapjes së rastit të falimentimit. Pala e interesuar që paraqet kundërshtimin duhet të ofroj prova mbi kundërshtimin e saj. Përveç nëse pala kundërshtuese kërkon ndryshe ose gjykata urdhëron ndryshe, supozimi mbi bazën e vlefshmërisë së kërkesës do të mbetet i vlefshëm derisa gjykata nuk vendos të kundërtën.
4. Gjkata nuk do të lejoj një kërkesë shtesë ndaj bazave për kundërshtim të kërkesës të

përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, e cila është e bazuar në:

4.1. një interes të pamaturuar (pa-arritur) deri në ditën e hapjes së procedurës së falimentimit;

4.2. një provë që nuk është dorëzuar brenda afateve ligjore të parapara në këtë ligj.

5. Gjykata, me qëllim të lejimit të një kërkesë sipas këtij neni do të vlerësojë:

5.1. çfarëdo kërkesë të pa përcaktuar ende ose të paarrtshme, përcaktimi ose arritshmëria e së cilës mund të shkaktonte vonesa të tepërta në administrimin e rastit; ose

5.2. vlerën e çfarëdo të drejte e cila rrjedh nga një e drejtë për mjet juridik për shkelje të detyrimeve për përmbushje të kontratës.

6. Gjykata nuk lejon asnjë kërkesë për rimbursim të një entiteti i cili është bashkarisht përgjegjës me debitorin ose që ka siguruar kërkesën e kreditorit, deri në masën që:

6.1. kërkesa e atij kreditori ndaj pasurisë falimentuese është e palejueshme;

6.2. kërkesa e tillë për rimbursim është e mundshme në rast të lejimit ose moslejimit të kërkesës për rimbursim; ose

6.3. entiteti deklaron të drejtën e zëvendësimit ose asignimit sipas ligjeve në fuqi ndaj të drejtave të atij kreditori.

7. Gjykata nuk lejon asnjë kërkesë prej asnjë entiteti, prona ose dëmet e të cilit janë të realizueshme sipas Kapitullit IV të këtij ligji, ose i cili është përfitues i bartjes së anuluar sipas Kapitullit IV të këtij ligji, përveç në rastet kur përfituesi i bartjes ka bërë kthimin e pronës për të cilën është përgjegjës si përfitues i bartjes.

Neni 51

Lista përfundimtare e kërkesave

1. Në procedurë të likuidimit, jo më larg se 10 ditë pas vendosjes për të gjitha kundërshtimet, Administratori përpilon një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave, së bashku me vlerën dhe statusin e secilës kërkesë, të cilën do t'ia dorëzojë gjykatës.

2. Administratori gjithashtu përcjell listën përfundimtare të kërkesave te komiteti i kreditorëve, nëse është themeluar një komitet i tillë.

3. Nëse gjykata nuk pranon asnjë kundërshtim ndaj listës përfundimtare brenda tridhjetë (30) ditëve prej dorëzimit të saj në gjykatë, lista konsiderohet listë përfundimtare për çdo qëllim.

4. Për shkak se plani i riorganizimit i adreson të gjitha kërkesat, plani i riorganizimit konsiderohet se brenda tij përfshinë listën përfundimtare të të gjitha kërkesave dhe përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk ka nevojë të përgatis ose deponoj listë shtesë të kërkesave në procedurë të riorganizimit.

Neni 52**Shpërndarja e pronave të pasurisë falimentuese ndaj kreditorëve**

1. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese e bënë shpërndarjen e pronave të pasurisë falimentuese ndaj kreditorëve, në momentin kur e sheh të arsyeshme dhe efektive për të bërë një shpërndarje të tillë.
2. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese bënë shpërndarjen në periudha të ndryshme kohore, me aprovim të gjykatës, në rastin se kur e sheh të arsyeshme dhe efektive për ta bërë shpërndarjen në ato periudha. Gjatë kryerjes së shpërndarjeve të tilla, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mbanë një rezerve të arsyeshme për kërkesat e mundshme të cilat mund të lindin si rezultat i një vendimi që pritet të merr gjykata në lidhje me ato kërkesa.
3. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese e bënë shpërndarjen në përputhje me prioritetet e shpërndarjeve të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 53**Shpërndarja ndaj kërkesave të lejuara**

Vetëm kërkesat e lejuara mund të përmbushen nga pasuria e falimentimit.

Neni 54**Kërkesat e siguruara dhe kërkesat e entiteteve tjera**

1. Nën kushtet e përcaktuara në këtë nen, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese e bart një pronë pjesë të pasurisë falimentuese ndaj entitetit kompetent i cili ka një barrë ose interes ndaj asaj prone. Nëse pasuria falimentuese ka interesa pozitive ndaj asaj prone, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese mund të bëjë kthimin e asaj vlere pozitive sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.
2. Në procedurë të riorganizimit, plani i riorganizimit përcakton shpërndarjen e çfarëdo prone në të cilën një entitet tjetër prej debitorit ka një interes.
3. Nëse më shumë se një entitet ka interes ndaj një prone pjesë të pasurisë falimentuese, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese i kërkon gjykatës të marrë vendim për caktimin e entitetit kompetent të cilit do të ia bëjë bartjen.
4. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese kërkon nga gjykata që kur ekzistojnë rrethana të përshtatshme, të nxjerr vendim për shitjen e pronës në të cilën ka interesa debitori dhe një entitet tjetër dhe të ardhurat nga ajo shitje t'i shpërndahen entiteteve që kanë interesa ndaj asaj prone, sipas vendimit të gjykatës. "Rrethana të përshtatshme" në kuptim të këtij paragrafi nënkupton situatën kur prona ka vlerë më të madhe se sa që ka interesa të entiteteve tjera nga debitori mbi atë pronë.

Neni 55**Kërkesat e pasiguruara**

Kërkesat e pasiguruara kanë prioritet në procedurë të likuidimit ndaj interesave në ekuitet dhe Administratori bënë shpërndarjen për kërkesat e pasiguruara pasi të ketë realizuar shpërndarjen ndaj kërkesave të siguruara, ose pasi të ketë ndarë rezervën e mjaftueshme për pagesën e kërkesave të siguruara.

Neni 56

Prioritetet në mes të kërkesave të pasigururara

1. Të gjitha kërkesat e pasiguruara supozohet se kanë prioritetin e njëjtë për qëllime të shpërndarjes, përveç kur decidivisht parashihet ndryshe në këtë ligj. Prioritetet e pagesës së kërkesave të pasiguruara rradhitën si vijon:

1.1. në radhë të parë paguhen shpenzimet administrative;

1.2. në radhë të dytë paguhen kërkesat që rrjedhin nga marrëdhëniet familjare ose kërkesat për kompenzim të viktimave;

1.3. në radhë të tretë paguhen kërkesat nga marrëdhënia e punës;

1.4. në radhë të katërt paguhen kërkesat tatimore;

1.5. në fund paguhet çfarëdo kërkesë e mbetur e pasiguar.

Neni 57

Shpenzimet administrative

1. Administratori paguan shpenzimet administrative si prioritet i parë në mesin e kërkesave të pasiguruara.

2. Shpenzimet administrative përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:

2.1. pagat e mbledhura pas hapjes së rastit të falimentimit;

2.2. obligimet tatimore të akumuluar prej momentin të hapjes së rastit të falimentimit;

2.3. kërkesat e ndërlidhura me një hua ose kredi për të cilën përfaqësuesi i pasurisë falimentuese ka marr aprovim nga gjykata; dhe

2.4. shpërblimet dhe shpenzimet e profesionistëve të punësuar me aprovim të gjykatës, përfshirë, por pa u kufizuar në shpërblimin e Administratorit ose profesionistëve tjerë, për të gjitha shpenzimet dhe shpërblimin e realizuar pas hapjes së rastit të falimentimit.

3. Përveç kur pasuria falimentuese është në gjendje të pa-aftësisë paguese të shpenzimeve administrative, administratori paguan shpenzimet administrative pa aprovim të gjykatës.

Neni 58

Kërkesat nga marrëdhëniet familjare ose kërkesat për kompenzim të viktimave

1. Administratori paguan detyrimet që rrjedhin nga një marrëdhënie familjare e debitorit ose nga një kërkesë për kompenzim të viktimave si prioritet i dytë në mesin e kreditorëve të pasiguar.

2. Kërkesat nga marrëdhëniet familjare konsiderohen të gjitha kërkesat që kanë lindur para inicimit të procedurës së falimentimit, që ndërlidhen me divorcin, kujdestarinë, alimentacionin

ose çështje tjera të rregulluara me ligjin për familjen.

3. Kërkesat për kompenzimin e viktimave konsiderohen të gjitha ato kërkesat që kanë lindur para inicimit të procedurës së falimentimit, e që ndërlidhen me kompenzimin e viktimave të shkaktuara nga një aktivitet penal i debitorit.

4. Përveç kur pasuria falimentuese është në gjendje të pa-aftësisë pagueze të shpenzimeve administrative, administratori mund të paguajë kërkesat nga marrëdhëniet familjare ose kërkesat për kompenzim të viktimave pa aprovim të gjykatës.

Neni 59

Kërkesat nga marrëdhënia e punës

1. Administratori i paguan kërkesat nga marrëdhënia e punës në rradhë të tretë të prioritetit brenda kërkesave të pasiguruara.

2. Kërkesat nga marrëdhënia e punës konsiderohen të gjitha kërkesat e punëtorëve të krijuara para inicimit të procedurës së falimentimit, për punëtorët që kanë qenë të angazhuar për debitorin përmes kontratës së punës, në përputhje me dispozitat e ligjit të punës në Kosovë.

Neni 60

Kërkesat tatimore

Administratori i paguan kërkesat tatimore që janë krijuar para inicimit të procedurës së falimentimit si prioritete të rangut të katërt në mesin e kreditorëve të pasiguruar.

Neni 61

Pagesat tjera të kërkesave të pasiguruara

Pas pagesës ose krijimit të rezervës për pagesë së kërkesave të siguruara dhe kërkesave të pasiguruara me prioritet, administratori do të paguajë kërkesat e mbetura të pasiguruara të cilat nuk janë në rangun e prioritetëve.

Neni 62

Interesat në ekuitet

1. Bartësit e interesave në ekuitet kanë prioritetin e fundit gjatë shpërndarjes, dhe përfaqësuesi i pasurisë falimentuese nuk do të bëjë asnjë shpërndarje përderisa nuk paguhen plotësisht kërkesat e lejueshme dhe kamatat ligjore ose të vendosura nga gjykata ndaj atyre kërkesave të siguruara ose të pasiguruara.

2. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese, para shpërndarjes ndaj bartësve të ekuitetit, i paguan edhe ato kërkesa të cilat nuk janë lejuar për arsyen e vetme që nuk janë regjistruar me kohë në gjykatë.

3. Vetëm pas realizimit të të gjitha kushteve të përcaktuara me këtë nen përfaqësuesi i pasurisë falimentuese e bënë shpërndarjen ndaj bartësve të ekuitetit.

Neni 63

Realizimi i shpërndarjeve - parimi pari passu

1. Asnjë shpërndarje nuk realizohet ndaj asnjë klase të kërkesave të pasiguruara ose bartësve të ekuitetit, përderisa kreditorët në klasët më të larta me prioritet më të lartë nuk janë paguar në tërësi.
2. Shpërndarje e realizuar do të konsiderohet çfarëdo pagese që ka pranuar kreditori për një detyrim të debitorit nga cilido burim tjetër ndaj pasurisë falimentuese.
3. Nëse nuk ka mjete për t'u paguar në tërësi një klasë e kreditorëve, atëherë shpërndarja do të bëhet pari passu në mes të kreditorëve të asaj klase.

KAPITULLI VI

RIORGANIZIMI

Neni 64

Debitori në posedim

1. Debitori do të ketë cilësinë e debitorit në posedim në një procedurë të riorganizimit, përveç:
 - 1.1. kur debitori kërkon emërimin e një Administratori në fillim të procedurës së falimentimit ose gjatë zhvillimit të procedurës;
 - 1.2. kur gjykata e shkarkon debitorin në posedim, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 65

Angazhimi i profesionistëve nga debitori në posedim

1. Debitori në posedim, me aprovim të gjykatës mund të punësoj një ose më shumë juristë, kontabilistë, vlerësuesë, drejtues ankandesh ose profesionistë tjerë të nevojshëm për të përfaqësuar ose ndihmuar debitorin në posedim gjatë zhvillimit të procedurës sipas Kapitullit VI të këtij Ligji.
2. Për t'u konsideruar i përshtatshëm për angazhim sipas paragrafit 1 të këtij neni, profesionisti duhet të dëshmoj se:
 - 2.1. nuk ka ndonjë interes ndaj pasurisë falimentuese; dhe
 - 2.2. nuk është palë e interesuar.
3. Nëse dy ose më shumë debitorë janë entitete të ndërlidhura, gjykata mund të aprovojë punësimin e profesionistëve të përbashkët, me kushtin që gjykata është e bindur se përfitimet nga angazhimi i profesionistëve të përbashkët janë shumë më të mëdha se sa dëmi që mund të shkaktohej nga një konflikt i interesit.

Neni 66**Shkarkimi i debitorit në posedim**

1. Gjykata shkarkon debitorin në posedim sipas kërkesës të vetë debitorit ose një pale të interesuar nëse vërtetohet se:

1.1. debitori ka mashtuar, ka vepruar jo-ndershëm ose me keqbesim para ose pas hapjes së rastit të falimentimit;

1.2. debitori nuk mund të menaxhoj afarizmin në mënyrë profitabile;

1.3. shumica e kreditorëve aktiv në adminsitrim të rastit kërkojnë shkarkimin e debitorit si debitor në posedim.

2. Pas shkarkimit, gjykata e emron një Administrator si përfaqësues të pasurisë falimentuese. Ky Administrator rishikon të gjithë afarizmin e debitorit dhe i rekomandon gjykatës dhe komitetit të kreditorëve se a mund të vazhdoj ky rast në procedurë të riorganizimit apo duhet të shndërrohet në likuidim.

3. Ne seancen dëgjimore për përcaktimin e Administratorit, sipas paragrafit 2 Gjykata nxjerr aktvendim me të cilin:

3.1. e autorizon Administratorin që rastin ta vazhdojë në procedurë të riorganizimit, ose;

3.2. rasti i riorganizimit shndërrohet në rast të likuidimit.

Neni 67**Komiteti i kreditorëve në rastin e riorganizimit**

1. Pesë (5) ditë pas dorëzimit të kërkesës për falimentim, gjykata i dërgon njoftim kreditorëve të pasiguarur me qëllim që ata të deklarojnë nëse dëshirojnë të jenë anëtarë të komitetit të kreditorëve.

2. Gjykata vendos për themelimin e komitetit të kreditorëve nëse të paktën tre kreditorë të pasiguarur shprehin interesimin për të shërbyer në komitetin e kreditorëve.

3. Të drejtat dhe obligimet e komitetit të kreditorëve janë:

3.1. pranon kopje të të gjitha shkresave që i drejtohen gjykatës nga debitori në posedim, në të njëjtën kohë me gjykatën;

3.2. punëson profesionistë sipas kushteve dhe kufizimeve të njëjta për punësimin e profesionistëve nga debitori në posedim;

3.3. pranon njoftimet nga gjykata dhe vendimet e gjykatës të cilat ndikojnë në të drejtat e kreditorëve;

3.4. thërret në seancë debitorin ose përfaqësuesit e debitorit, të cilët obligohet t'i

përgjigjen pyetjeve të komitetit të kreditorëve në lidhje me rastin. Çdo përgjigje e debitorit ose përfaqësuesit të tij do të konsiderohet si deklaratë nën betim;

3.5. shpërndan informacionin e marr nga kreditorët që nuk janë pjesë e komitetit të kreditorëve;

3.6. përgatit rekomandime për planin e riorganizimit për të cilin votojnë kreditorët;

3.7. çfarëdo të drejte ose obligimi tjetër që mund t'ia caktoj gjykata, përderisa ato të drejta ose detyrime janë në përputhje me këtë ligj.

Neni 68

Propozimi i planit të riorganizimit

1. Pala e interesuar mund të propozojë një plan të riorganizimit vetëm nëse i lejohet sipas këtij neni.

2. Debitori në posedim e ka të drejtën ekskluzive për të dorëzuar në gjykatë planin e riorganizimit ne afat prej njëqind e njëzet (120) ditëve prej hapjes së rastit. Nëse debitori dorëzon planin para kalimit të këtij afati, afati ndërpritet.

3. Gjykata mund të shkurtojë ose zgjas afatin ekskluziv të debitorit sipas paragrafit 2 të këtij neni, nëse një palë e interesuar i dëshmon gjykatës se zgjatja ose shkurtimi i këtij afati ndikon dukshëm në rritjen e mundësisë për riorganizim të debitorit.

4. Pas kalimit të afatit të paraparë me paragrafin 2 të këtij neni ose zgjatjes ose shkurtimeve të afatit sipas paragrafit 3 të këtij neni, secila palë e interesuar deponon një plan për riorganizimin e debitorit.

Neni 69

Përmbajtja e detyrueshme dhe e lejueshme e planit të riorganizimit

Gjykata shqyrton dhe konfirmon një plan të riorganizimit vetëm nëse është në përputhje nga neni 70 deri ne nenin 76 të këtij ligji.

Neni 70

Propozuesi i planit

Personi, entiteti i cili propozon planin për riorganizim të debitorit ne pajtim me këtë ligj njihet si "propozuesi i planit".

Neni 71

Specifikimi dhe klasifikimi i kërkesave

1. Plani klasifikon kreditorët dhe bartësit e ekuitetit.

2. Plani bën një ndarje në mes të kreditorëve dhe bartësve të ekuitetit, në klasë të ndryshme, varësisht nga të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas legjislacionit në fuqi, nën këto kushte:

2.1. propozuesi i planit vendos një kërkesë në një klasë të caktuar vetëm nëse ajo kërkesë është substancialisht e ngjashme me kërkesat tjera të vendosura në atë klasë. Nuk lejohet që një kërkesë e siguruar të vendoset në një klasë të njejtë me një kërkesë të pasiguruar ose të bartësit e ekuitetit edhe nëse i njejtë person është bartës i kërkesës së siguruar, kërkesës së pasiguruar dhe ekuitetit;

2.2. propozuesi i planit vendos një kërkesë të pasiguruar në më shumë se një klasë, vetëm nëse ka një arsyetim afarist pse e ka bërë atë ndarje. Një arsyetim i tillë mund të jetë ndarja e tepricës së pasiguruar të kreditorit të siguruar nga pjesa tjetër e kërkesave të siguruara, të kreditorit i cili e furnizon pasurinë falimentuese me mallra ose shërbime të kredituara; dhe

2.3. propozuesi i planit mund të përcaktojë një klasë.

Neni 72

Trajtimi i njejtë i kërkesave brenda klasës së njejtë

Brenda një klase, të gjithë kreditorët e asaj klase duhet të kenë trajtim të barabartë , përveç nëse propozuesi i planit dëshmon se një anëtar i asaj klase të kreditorëve ka pranuar të ketë trajtim më të pafavorshëm se anëtarët tjerë të asaj klase.

Neni 73

Dëmtimi i kërkesës

1. Konsiderohet se plani i riorganizimit e dëmton një kërkesë nëse e ndryshon ose e afekton çfarëdo aspekti të kërkesës, duke përfshirë pa kufizime datën e maturitetit të kërkesës, zvogëlimin ose eliminimin e interesit ose kryegjës, ose shkëmbimin e kërkesës me një pronë tjetër ose me një kërkesë tjetër.

2. Plan i riorganizimit nuk e dëmton një kërkesë nëse:

2.1. nuk ka për qëllim të ndryshoj ose ndikoj në kërkesë;

2.2. e paguan kërkesën e plotë në të gatshme, së bashku me interesin e mbledhur deri në momentin e hapjes së rastit të falimentimit; ose

2.3. propozuesi i planit:

2.3.1. e përmirson çfarëdo shkelje deri në ditën në të cilën hapet rasti;

2.3.2. e rikthen datën origjinale të maturitetit të kërkesës nëse data e maturitetit është përshpejtuar; dhe

2.3.3. e kompenzon bartësin për çfarëdo dëmi që ka pësuar si rezultat i shkeljes që i ka ndodhur kreditorit.

Neni 74**Dispozitat e detyrueshme që duhet t'i përmbajë plani i riorganizimit**

1. Dispozitat e planit të riorganizimit duhet të specifikojnë:

- 1.1. klasët e kërkesave ose bartësit e ekuitetit të cilët nuk preken nga plani;
- 1.2. propozimin për trajtimin e secilës klasë të kërkesave të cilat preken nga plani;
- 1.3. propozimin e debitorit për emërimin e menaxhmentit të tij dhe propozimin për shpërblimin që do t'i paguhet atij menaxhmenti; dhe
- 1.4. ndryshimet e nevojshme në aktet themeluese të debitorit, nëse plani konfirmohet.

Neni 75**Dispozitat fakultative të planit të riorganizimit**

1. Dispozitat fakultative të planit të riorganizimit mund të:

- 1.1. prekin ose t'i lënë të paprekura klasët e kërkesave të siguruara ose të pasiguruara dhe të bartësve të ekuitetit;
- 1.2. ofrojë supozime për pranimin, refuzimin ose transferimin e një kontrate të papërbushur sipas kushteve të njehta të parapara në Kapitullin IV të këtij ligji, nën kushtet se këto kontrata të papërbushura veç se nuk janë refuzuar sipas atij Kapitulli;
- 1.3. ofrojë trajtimin si vijon për kërkesat të mbajtura nga debitori:
 - 1.3.1. zgjidhjen ose përshtatjen e çfarëdo kërkesë ose interesi që i takon debitorit ose pasurisë falimentuese;
 - 1.3.2. përbarimin e kërkesës së tillë ose interesit nga përfaqësuesi i pasurisë falimentuese;
- 1.4. ofrojë mundësinë e shitjes së të gjitha pronave të pasurisë falimentuese dhe shpërndarjen e mjeteve të grumbulluara nga shitjet të kreditorëve dhe bartësit të ekuitetit;
- 1.5. ofrojë modifikimin e të drejtave të kreditorëve të siguruar, të kreditorëve të pasiguruar ose t'i lejë të paprekuar të drejtat e cilësdo klasë të kërkesave; dhe
- 1.6. përfshijë çfarëdo dispozite të rëndësishme që nuk është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 76**Masat e nevojshme për implementimin e elementeve financiare të planit**

1. Të gjithë planet e riorganizimit duhet të përcaktojnë masa adekuate për implementimin e tyre me qëllim që debitori të mos kërkojë lehtësira financiare shtesë pas konfirmimit të planit. Masat

adekuate të implementimit mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në:

- 1.1. mbajtjen nga debitori të një pjese ose të të gjithë pasurisë falimentuese;
- 1.2. transferimin e një pjese ose të të gjithë pasurisë falimentuese te një ose më shumë entitete të themeluara para ose pas konfirmimit të planit;
- 1.3. bashkimin e debitorit më një ose më shumë persona;
- 1.4. shitjen e një pjese ose të të gjithë pasurisë falimentuese, pa marrë parasysh a bëhet ajo shitje me ose pa barrat e ngarkuara ndaj pasurisë falimentuese, ose shpërndarjen e pasurisë falimentuese te të gjithë personat që kanë interesa në atë pasuri;
- 1.5. përmbushjen ose ndryshimin e një barre;
- 1.6. trajtimin ose heqjen dorë nga një shkelje e një detyrimi;
- 1.7. zgjatjen e afatit të maturitetit, ndryshimin e normave të interesit, kushteve tjera të instrumenteve financiare të kredive, instrumenteve tjera kreditore; ose;
- 1.8. ofrimin e instrumenteve financiare garantuese për entitetet me kërkesa për garancione:
 - 1.8.1. në të gatshme;
 - 1.8.2. ndaj pronave;
 - 1.8.3. ndaj instrumenteve financiare aktuale;
 - 1.8.4. për instrumentet financiare të reja; ose
 - 1.8.5. për çfarëdo qëllimi të përshtatshëm.

Neni 77

Procedura për propozim të planit shpalosjet

1. Propozuesi i planit duhet të dorëzoj deklaratën mbi shpalosjen së bashku me planin për riorganizim.
2. Deklarata për shpalosjen duhet të përfshijë informata të mjaftueshme që i mundësojnë kreditorit ose bartësit të interesave ndaj ekuitetit të votojnë mbi planin. Informata të tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në përshkrime të shkurtëra:

- 2.1. arsyet e debitorit ose përfaqësuesit të pasurisë falimentuese për kërkesën e riorganizimit;
- 2.2. ndryshimet që do të bëhen nga plani i riorganizimit do të jenë përfituese për debitorin e riorganizuar;

2.3. shpërndarjet ndaj kreditorëve sipas planit e tejkalojnë vlerën e shpërndarjeve që kreditorët do të pranonin nëse debitori do të shkonte në likuidim;

2.4. rrjedhën e parasë së debitorit të pritshme për pesë (5) vitet e ardhshme pas konfirmimit të pritshëm të planit; nëse debitorët do të pranonin shpërndarje para kalimit të periudhës pesë (5) vjeçare, atëherë rrjedhën e parasë së gatshme gjatë realizimit të këtyre shpërndarjeve.

3. Para se propozuesi i planit të shpërndaj planin e riorganizimit për votim, gjykata duhet të aprovojë deklaratën mbi shpalosjet. Gjukata aprovon deklaratën mbi shpalosjet vetëm nëse propozuesi i dëshmon gjykatës përmes provave se ka përfshirë të gjitha informatat që janë të nevojshme për informim të drejtë të kreditorëve në lidhje me votimin për ose kundër planit.

4. Gjukata nuk do të llogarisë votat e dhëna para aprovimit të deklaratës mbi shpalosjet.

5. Nëse gjykata e aprovon deklaratën mbi shpalosjet, nxjerr aktvendim me të cilin e urdhëron propozuesin e planit që të shpërndajë planin e riorganizimit, deklaratën mbi shpalosjet dhe fletëvotimet të të gjithë kreditorët ose bartësit e ekuitetit të cilët kanë të drejtë vote mbi planin. Në aktvendimin e gjykatës duhet të theksohet edhe data për kthimin e fletëvotimeve të plotësuara, data për dorëzimin e ndonjë kundërshtimi të mundshëm dhe data e seancës dëgjimore për konfirmim të planit.

6. Propozuesi i planit nuk ka nevojë të dorëzojë fletëvotimet, deklaratën mbi shpalosjet dhe planin e riorganizimit të cilado klasë që konsiderohet se veç se e ka refuzuar ose aprovuar planin.

Neni 78

Niveli i nevojshëm i votave për konfirmim të planit

1. Një klasë konsiderohet se e ka pranuar planin e riorganizimit nëse kreditorët që mbajnë të paktën 50% të kërkesave brenda asaj klase votojnë në favor të planit të riorganizimit.

2. Një klasë konsiderohet se e ka pranuar planin e riorganizimit pa pasur nevojë për votim nëse kërkesat ose interesat mbi ekuitet brenda asaj klase mbesin të paprekura nga plani.

3. Një klasë konsiderohet se e ka refuzuar planin e riorganizimit pa pasur nevojë për votim nëse plani i eliminon kërkesat ose interesat mbi ekuitet të asaj klase.

Neni 79

Kushtet për konfirmim konsensual të planit

1. Përveç për konfirmim të planit të cilin të gjitha klasët nuk e pranojnë të përfshirë në nenin vijues, gjykata mund të konfirmoj një plan të riorganizimit vetëm nëse propozuesi i planit i dëshmon gjykatës se:

1.1. plani i riorganizimit është në përputhje me këtë ligj dhe se propozuesi i planit ka vepruar në përputhje me të gjitha dispozitat e këtij ligji;

1.2. propozuesi ka propozuar planin në mirëbesim;

1.3. plani i riorganizimit parasheh se secili kreditor ose bartës i ekuitetit i prekur nga plani do të pranojnë të paktën atë sa do të kishin pranuar në rastin kur debitorit do të shkonte në likuidim;

1.4. metodat e implementimit të planit janë të përshtatshme, përmes të cilës duhet t'i dëshmohet gjykatës se:

1.4.1. konfirmimi i planit të riorganizimit nuk do të pasojë me nevojën për të hapur edhe një rast të ri të falimentimit kundër debitorit sipas këtij ligji; dhe

1.4.2. të gjitha pagesat dhe shpërndarjet sipas planit të riorganizimit bëhen në afatet e caktuara kohore; dhe

1.4.3. të gjitha klasat e kërkesave dhe bartësve të ekuitetit kanë pranuar planin e riorganizimit ose janë të paprekur nga plani i riorganizimit.

Neni 80

Kushtet për konfirmim jo-konsensual të planit

1. Gjykata e konfirmon një plan të riorganizimit edhe nëse nuk është pranuar nga të gjitha klasat, vetëm nëse propozuesi i planit i dëshmon gjykatës se:

1.1. i përfshinë të gjitha kushtet për konfirmim të planit të parapara në neni paraprak, që kanë të bëjnë me pranimin nga të gjitha klasat e prekura nga plani;

1.2. parasheh pagesë të plotë për kreditorët;

1.3. nuk parasheh shpërndarje ose pagesë për klasat e kreditorëve ose bartësit e ekuitetit pa u paguar në tërësi ose pa u pranuar plani nga të gjitha klasat e kërkesave ose bartësve të ekuitetit që kanë prioritet.

2. Për qëllime të këtij neni, pagesa e plotë nuk ka nevojë të jetë pagesë në të gatshme. Konsiderohet se kreditori do të paguhet në tërësi nëse propozuesi i planit ofron prova se plani i riorganizimit parasheh shpërndarje të pronave ndaj kreditorëve, prona të cilat kanë vlerë të barabartë me vlerën e kërkesave të lejuara të atyre kreditorëve. Prona konsiderohen cilado në vijim, ose kombinimi i cilësdo në vijim:

2.1. të gatshmet;

2.2. instrumentet e lejuashme financiare;

2.3. pronat e luajtshme ose të paluajtshme;

2.4. interesa në ekuitet të debitorit ose të ndonjë entiteti tjetër.

3. Nëse plani i riorganizimit propozon shpërndarje të pronave ndaj kreditorëve të siguruar me pagesë të plotë ndaj kërkesave të siguruara, dhe nëse një pagesë konsiston në pagesë përmes instrumentit të lejuashëm financiar, atëherë kreditori i siguruar pas pranimi të instrumentit financiar do të ruajë barrën mbi pronën deri sa instrumenti financiar të pagujë në tërësi atë kërkesë të kreditorit.

Neni 81**Pasojat juridike të konfirmimit të planit**

1. Dispozitat e planit të konfirmuar të riorganizimit janë të detyrueshme për debitorin, entitetet që lëshojnë instrumente financiare sipas planit, cilindo entitet që blen pronë në kuadër të planit, kreditorët dhe bartësit e ekuitetit, pa marrë parasysh se a janë prekur interesat e kreditorëve ose bartësve të ekuitetit dhe pa marrë parasysh se a kanë votuar në favor të planit ata kreditorë ose bartës të ekuitetit.

2. Përveç nëse parashihet ndryshe në planin e riorganizimit ose me aktvendimin e gjykatës për konfirmimin e planit të riorganizimit, të gjitha të drejtat mbi pasurinë e falimentimit pas konfirmimit të planit i takojnë debitorit.

3. Përveç nëse ndryshe parashihet në plan, pas konfirmimit të planit të riorganizimit, pronat të cilat janë të trajtuara në planin e riorganizimit janë të lira nga të gjitha kërkesat e ekuitetit të kreditorëve dhe bartëseve të ekuitetit të debitorit.

4. Përveç nëse ndryshe parashihet në plan, konfirmimi i planit:

4.1. e liron debitorin nga çfarëdo kërkesë që ka mundur të krijohet para konfirmimit të planit, pa marrë parasysh se:

4.1.1. a është dorëzuar një provë për kërkesën sipas këtij ligji;

4.1.2. nëse është dorëzuar, është pranuar si e lejuar ose është deklaruar e palejueshme sipas këtij ligji;

4.1.3. a e ka pranuar planin paraqitësi i kërkesës.

4.2. i ndërprejnë të gjitha të drejtat dhe interesat në ekuitet të bartësve të ekuitetit, siç parashihet në plan.

5. Një lirim i akorduar sipas këtij Kapitulli nuk e liron debitorin i cili është individ, të cilit nuk i është akorduar lirim sipas Kapitullit VIII të këtij Ligji ose të çfarëdo detyrimi të përjashtuar nga lirim sipas Kapitullit VIII të këtij Ligji.

Neni 82**Pasojat juridike në rast të dështimit të përmbushjes së planit**

1. Kërkesa për revokim të konfirmimit të planit mund të paraqitet nga një palë e interesuar në gjykatë nëse pala e interesuar:

1.1. mund të dëshmojë se propozuesi i planit ka marrë votat për konfirmim të planit si rezultat i mashtrimit; dhe

1.2. një kërkesë të tillë e paraqet brenda gjashtë (6) muajve pas konfirmimit të planit.

2. Nëse debitori në riorganizim ose një palë tjetër nuk vepron në përputhje me dispozitat e planit të konfirmuar të riorganizimit, pala e interesuar:

2.1. mund t'i paraqes kërkesë gjykatës për detyrim të palës për të vepruar në përputhje me planin e riorganizimit dhe të kërkojë nga gjykata kompenzimin e dëmit sikurse plani i organizimit të jetë një kontratë sipas dispozitave të ligjit për marrëdhënie detyimore;

2.2. mund t'i paraqes kërkesë gjykatës për të anuluar pjesën e planit të pa realizuar, të tërheq lirin që i është dhënë kreditorit dhe ta shndërrojë rastin në likuidim;

2.3. mund t'i paraqes kërkesë gjykatës për të anuluar pjesën e planit të pa realizuar, të tërheq lirin që i është dhënë kreditorit dhe ta pushon rastin.

Neni 83

Shndërrimi i riorganizimit në likuidim

1. Gjkata nxjerr aktvendim për shndërrimin e riorganizimit në likuidim nëse pala e interesuar i dëshmon gjykatës se:

1.1. është duke u shkaktuar humbje substanciale dhe e vazhdueshme e pasurisë falimentuese dhe nuk ka ndonjë indikacion se situata mund të përmisohet;

1.2. është duke u keqmenaxhuar me përmasa të mëdha pasuria falimentuese;

1.3. ka kaluar më shumë se 1 vit nga hapja e rastit, përveç nëse gjykata e shoh të arsyeshme të shtyj afatin, shtyrje e cila nuk mund të kalojë tetëmbëdhjetë (18) muajshin nga dita e hapjes së rastit;

1.4. debitori në posedim ka dështuar të sigurojë ose të mirëmbajë një policë të sigurimit dhe si rezultat i ka shkaktuar reziqe pasurisë falimentuese ose qytetarëve;

1.5. debitori në posedim nuk i është përfillur një urdhëri ose aktvendimi të gjykatës;

1.6. debitori në posedim nuk i ka paguar detyrimet tatimore në kohë, detyrime këto të krijuara pas akordimit të lirit ndaj debitorit; ose

1.7. debitori në posedim nuk e dorëzuar deklaratën mbi shpalosjet, planin e riorganizimit dhe kërkesën për konfirmim të planit brenda afateve të caktuara nga gjykata.

Neni 84

Mbyllja e rastit

Gjkata me aktvendim vendos për mbylljen e rastit kur të gjitha obligimet e dala nga plani i riorganizimit konsiderohen të përmbushura.

KAPITULLI VII LIKUIDIMI

Neni 85 Emërimi i Administratorit

1. Gjykata cakton një Administrator në afatin jo me vonë se tre (3) ditë në këto raste:
 - 1.1. pas dorëzimit të kërkesës për likudim nga debitori;
 - 1.2. pas hapjes së procedurës së likudimit sipas kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit të bërë nga kreditorët;
 - 1.3. pas shndërrimit të riorganizmit në likuidim;
 - 1.4. pasi që gjykata e shkarkon debitorin në posedim ose një Administrator të emëruar më herët.

Neni 86 Kualifikimet, trajnimi dhe licencimi i administratorëve

1. Për administrator falimentues mund të caktohet personi i cili:
 - 1.1. ka të paktën të përfunduara studimet në sistemin katër (4) vjeçar ose Master nga fusha e drejtësisë ose ekonomisë;
 - 1.2. ka njohuri mbi veprimtaritë e bizneseve, menaxhimin ose mbylljen e bizneseve;
 - 1.3. ka përfunduar trajnime profesionale për veprimtaritë e bizneseve, menaxhimin ose mbylljen e tyre;
 - 1.4. ka se paku pesë (5) vjet përvojë pune në profesion;
 - 1.5. ka njohuri mbi këtë ligj, dhe
 - 1.6. është pajisur me certifikatë nga një institucion kompetent në lidhje me njohuritë për këtë ligj dhe çfarëdo akti nënligjor të nxjerr për zbatimin e këtij ligji.
2. Kandidati për Administrator konsiderohet i kualifikuar sipas këtij ligji nëse është anëtarë i një shoqate profesionale në Kosovë ose i një shoqate profesionale në Unionin Evropian ose Shtete të Bashkuara të Amerikës, dhe shoqata duhet të ketë në fokus të saj falimentimin dhe procedurat e falimentimit.
3. Kandidati për Administrator nuk është e nevojshme të jetë Avokat ose Kontabilist i licencuar.
4. Regjistri i administratorëve falimentues do të mirëmbahet nga Ministria e Drejtësisë.

5. Kandidatët që i plotësojnë kushtet për t'u bërë pjesë e regjistrit të administratorëve falimentuese nëse i plotëson kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni, paraqesin kërkesën së bashku me dëshminë për anëtarësim në një shoqatë profesionale pranë Ministrisë së Drejtësisë e cila është e obliguar që pas verifikimit të kërkesës, ta përfshijë kandidatin në regjistrin e administratorëve falimentues.

6. Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet sipas paragrafit 2 të këtij neni, duhet t'i nënshtrohen provimit kualifikues për të dëshmuar njohuritë e tij nga fusha e falimentimit të organizuar nga Ministria e Drejtësisë.

7. Procedurat për organizimin, përmbajtjen dhe mbajtjen e provimit do të rregullohet me akt nenligjor të nxjerr nga Ministria e Drejtësisë.

8. Për Administrator falimentues nuk mund të caktohen:

8.1. personat të cilët kanë lidhje familjare ose biznesi me gjyqtarin i cili është duke e zhvilluar procedurën e falimentimit;

8.2. personat të cilët kanë lidhje familjare ose biznesi me debitorët ose nëpunësit, drejtorët, punonjësit, aksionaret ose kreditorët e debitorit;

8.3. personat të cilët janë nëpunës, drejtor, punonjës, aksionarë të konkurrenteve të drejtpërdrejt të biznesit të debitorit;

8.4. personat të cilët kanë falimentuar në kohën e emërimit;

8.5. personat të cilët në përputhje me ligjet e tjera të Republikës së Kosovës, nuk mund të emërohen si drejtore të një shoqërie tregtare.

Neni 87

Shkarkimi i Administratorit

1. Nëse gjykata e shih të nevojshme dhe të arsyeshme, ajo vendos për shkarkimin e Administratorit nga rasti konkret.

2. Arsye për shkarkim sipas këtij ligji konsiderohet, por nuk kufizohet në vetëm:

2.1. dëshmi se Administratori nuk i plotëson kualifikimet sipas nenit 86 të këtij ligji; ose

2.2. dëshmi se Administratori ka kryer ndonjë vepër penale ose ka mashtruar gjatë administrimit të rastit, rrethana të cilat e vejnë në pikëpyetje integritetin moral dhe ndershmërinë e Administratorit;

2.3. me votimin e shumicës së kreditorëve për shkarkimin e administratorit të rastit, në një mbledhje të veçantë të kreditorëve të thirrur vetëm me qëllim të shkarkimit të Administratorit, ose kryerjes së pakenaqshme të detyrave të administratorit.

Neni 88

Obligimet e përgjithshme të Administratorit

1. Administratori do të:

1.1. realizojë të hyra nga pronat e pasurisë falimentuese të cilat janë nën administrimin e tij dhe do të realizojë të hyrat nga pasuria falimentuese sa më shpejtë që është e mundur, në interes të të gjithë palëve të interesuara.

1.2. do të jetë përgjegjës për të gjitha pronat që i pranon;

1.3. do të thërras dhe udhëheq të gjitha takimet e komitetit të kreditorëve;

1.4. rishikoj të gjitha çështjet financiare të debitorit;

1.5. me qëllim të realizimit të objektivave, mund të hetoj provat e kërkesave dhe kundërshtoj lejimin e një kërke të papërshtatshme;

1.6. nëse është e këshillueshme, të kundërshtojë lirin e debitorit;

1.7. përveç nëse gjykata urdhëron ndryshe, të jap informata mbi pasurinë falimentuese dhe mbi administrimin e pasurisë falimentuese të palëve të interesuara; dhe

1.8. përgatis raportin final dhe të dorëzojë raportin final mbi administrimin e rastit në gjykatë.

2. Administratori nuk ka përgjegjësi personale për çfarëdo humbje që mund t'i shkaktohet kreditorit, debitorit, aksionarëve, ortakëve, pronarëve, pasurisë falimentuese ose ndonjë pale tjetër për pasojat që mund të jenë shkaktuar si rezultat i një vendimi të marrë nga Administratori në kuadër të ushtrimit të funksioneve të tij, funksione të cilat janë ushruar me kujdes dhe në afate të duhura kohore.

Neni 89

Angazhimi i profesionistëve nga Administratori

1. Administratori, me aprovim të gjykatës angazhon një ose më shumë juristë, kontabilistë, vlerësues pronash, drejtues ankandesh, ose profesionistë të tjerë të cilës i ndihmojnë Administratorit ose e përfaqësojnë Administratorin gjatë kryerjes së detyrave të tij sipas ligjit.

2. Për të qenë i përshtatshëm për t'u angazhuar si profesionist, personi duhet të dëshmojë se:

2.1. nuk ka ndonjë interes në kundërshtim me interesat e pasurisë falimentuese;

3. Gjkata autorizon Administratorin të veprojë si jurist ose kontabilist i pasurisë falimentuese nëse e konsideron se një autorizim i tillë i shërben më së miri pasurisë.

4. Nëse dy ose më shumë debitorë janë entitete të ndërlidhura, gjykata mund të aprovojë angazhimin e profesionistëve të përbashkët, me kushtin që gjykata është e bindur që angazhimi

i tillë do të jetë më i dobishëm për pasurinë falimentuese se sa i dëmshëm si rezultat i ndonjë konflikti të interesave.

Neni 90

Shpërblimi i Administratorit

1. Administratori paguhet bazuar në shpërndarjet që i bëhen kreditorëve. Pagesat e tilla konsiderohen shpenzime administrative.

2. Gjykata duhet të aprovojë shpërblimin dhe mbulesën e shpenzimeve të Administratorit, para se të paguhet Administratori.

3. Gjykata lejon pagesën e Administratorëve për shërbimet që i ofron administratori, pasi që ato shërbime të jenë ofruar. Shpërblimi i tillë do jetë:

3.1. njëzet e pesë (25 %) përqind të shumës deri në pesëmijë (5,000) Euro, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni;

3.2. dhjetë (10%) përqind të shumës prej pesëmijë e një (5,001) Euro deri në pesëdhjetë mijë (50,000) Euro, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni;

3.3. pesë (5%) përqind të shumës prej pesëdhjetë mijë e një (50,001) Euro deri në një milion (1,000,000) Euro, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni;

3.4. tre (3%) përqind të shumave mbi një milion (1,000,000) Euro, në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni;

4. Gjykata bënë pagesat sipas paragrafit 3 të këtij neni në përputhje me vlerën totale të shpërndarjeve që Administratori i bënë ndaj palëve të interesuara, duke mos e përfshirë debitorin, por duke e përfshirë bartësit e kërkesave të siguruara.

5. Administratori do ti marr të paktën një qind (100) Euro si shpërblim për secilin rast në të cilin ka shërbyer si Administrator falimentues.

Neni 91

Komiteti i kreditorëve me rastin e likuidimit

1. Brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e kërkesës për likuidim, gjykata kërkon nga kreditorët e pasiguruar të shpeshin interesimin e tyre për të marrë pjesë në komitetin e kreditorëve.

2. Në komitetin e kreditorëve do të përfshihen së paku tre (3) dhe jo më shumë se pesë (5) kreditorë. Gjykata i jep përparësi kreditorëve me kërkesat më të mëdha të pasiguruara dhe të cilët dëshirojnë të shërbejnë në komitetin e kreditorëve. Nëse më pak se tre (3) kreditorë të tillë dëshirojnë të shërbejnë në komitete, atëherë nuk do të themelohet komiteti.

3. Të drejtat dhe detyrat e komitetit të kreditorëve janë:

3.1. pranon kopje të të gjitha shkresave që i drejtohen gjykatës nga debitori në posedim, në të njëjtën kohë me gjykatën;

3.2. punëson profesionistë sipas kushteve dhe kufizimeve të njëjta për punësimin e profesionistëve nga Administratori;

3.3. pranon njoftimet nga Gjykata dhe vendimet e Gjykatës të cilat ndikojnë në të drejtat e kreditorëve;

3.4. thërret në interpelancë debitorin ose përfaqësuesit e debitorit, të cilët obligohet t'i përgjigjen pyetjeve të komitetit të kreditorëve në lidhje me rastin. Çdo përgjigje e debitorit ose përfaqësuesit të tij do të konsiderohet si deklaratë nën betim;

3.5. me aprovim të gjykatës, pas njoftimit se Administratori nuk do të ndërmarrë një veprim të tillë, inicon procedurë për anulim të bartjes sipas Kapitullit IV të këtij ligji;

3.6. shpërndan informacionin e marrë nga kreditorët që nuk janë pjesë e komitetit të kreditorëve;

3.7. çfarëdo të drejte ose obligimi tjetër që mund t'ia caktoj gjykata, përderisa ato të drejta ose detyrime janë në përputhje me këtë ligj.

Neni 92

Dispozitat e veçanta për likuidimin e formave të ndryshme të shoqërive tregtare

1. Përveç detyrave të Administratorit të përcaktuara në nenin 88 të këtij ligji, Administratori duhet të siguroj lirim sipas nenit 105 të këtij ligji, ekzistenca formale e secilit debitor përveç debitorit individual duhet të përfundojë përmes shuarjes së shoqërisë tregtare, jo më vonë se në ditën e mbylljes së rastit.

2. Shuarja e tillë duhet të bëhet në përputhje me dispozitat në fuqi të parapara në këtë Kapitull të këtij Ligji.

3. Nëse Administratori është ende duke shërbyer si Administrator në rastin e falimentimit pas lirimit nga borxhet të debitorit, Administratori do të ketë kompetenca ekskluzive për të realizuar të gjitha kërkesat dhe për të ndërmarrë të gjitha veprimet në emër të debitorit deri në mbylljen e rastit.

Neni 93

Shoqëritë Aksionare

1. Në rastet kur debitori është shoqëri aksionare sipas ligjit për shoqëritë tregtare, në momentin e mbylljes së rastit ose para mbylljes së rastit, në përputhje me dispozitat e parapara në këtë kapitull dhe sipas ligjit për shoqëritë tregtare, Administratori do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shuarjen e shoqërisë aksionare:

1.1. veprimet për shuarjen e shoqërisë aksionare përjashtojnë të gjitha kërkesat për thirrje të mbledhjeve të bartësve të aksioneve të shoqërisë. Kërkesat e përjashtuara përfshijnë edhe përjashtimin e kërkesës për dërgimin e njoftimeve për thirrje të mbledhjeve ose mbajtjen e çfarëdo takimi në lidhje me shuarjen e shoqërisë;

1.2. veprimet e ndërmarra nga Administratori për shuarjen e shoqërisë aksionare përfshijnë edhe dërgimin e njoftimeve ndaj regjistrave të biznesit dhe administratës

tatimore në lidhje me mbylljen e rastit.

2. Vetëm Administratori ka të drejtë të paraqes kërkesa që rrjedhin nga një ligj tjetër përveq ligjit të falimentimit, në emër të kreditorëve ndaj themeluesve, aksionarëve, zyrtarëve, drejtorëve, agentëve ose menaxherëve të lartë të shoqërisë aksionare.

3. E drejta për të paraqitur kërkesa sipas paragrafit 2 të këtij neni skadon në momentin e mbylljes së rastit të falimentimit ose më së largu 2 vite nga dita e hapjes së rastit të falimentimit.

Neni 94

Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara

1. Në rastet kur debitori është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit për shoqëritë tregtare, në momentin e mbylljes së rastit ose para mbylljes së rastit, në përputhje me dispozitat e parapara në këtë kapitull dhe sipas ligjit për shoqëritë tregtare, Administratori do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shuarjen e shoqërisë aksionare:

1.1. veprimet për shuarjen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar përjashtojnë të gjitha kërkesat për thirrje të mbledhjeve të bartësve të aksioneve të shoqërisë. Kërkesat e përjashtuara përfshijnë edhe përjashtimin e kërkesës për dërgimin e njoftimeve për thirrje të mbledhjeve ose mbajtjen e çfarëdo takimi në lidhje me shuarjen e shoqërisë;

1.2. veprimet e ndërmarra nga Administratori për shuarjen e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar përfshijnë edhe dërgimin e njoftimeve ndaj regjistrave të biznesit dhe administratës tatimore në lidhje me mbylljen e rastit.

2. Vetëm Administratori ka të drejtë të paraqes kërkesa që rrjedhin nga një ligj tjetër përveq ligjit të falimentimit, në emër të kreditorëve ndaj themeluesve, aksionarëve, zyrtarëve, drejtorëve, agentëve ose menaxherëve të lartë të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

3. E drejta për të paraqitur kërkesa sipas paragrafit 2 të këtij neni skadon në momentin e mbylljes së rastit të falimentimit ose më së largu dy (2) vite nga dita e hapjes së rastit të falimentimit.

Neni 95

Ortakëritë e përgjithshme

1. Në rastet kur debitori është ortak i përgjithshëm në ortakëri të përgjithshme të themeluar sipas ligjit për shoqëritë tregtare, në momentin e mbylljes së rastit ose para mbylljes së rastit, në përputhje me dispozitat e parapara në këtë kapitull dhe sipas ligjit për shoqëritë tregtare, Administratori do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shuarjen e ortakërisë së përgjithshme.

1.1. veprimet për shuarjen e ortakërisë së përgjithshme përjashtojnë të gjitha kërkesat për thirrje të mbledhjeve të ortakëve. Kërkesat e përjashtuara përfshijnë edhe përjashtimin e kërkesës për dërgimin e njoftimeve për thirrje të mbledhjeve ose mbajtjen e çfarëdo takimi në lidhje me shuarjen e ortakërisë;

1.2. veprimet e ndërmarra nga Administratori për shuarjen e ortakërisë përfshijnë edhe dërgimin e njoftimeve ndaj regjistrave të biznesit dhe administratës tatimore në lidhje me mbylljen e rastit.

2. Vetëm Administratori ka të drejtë të paraqes kërkesa që rrjedhin nga një ligj tjetër përveq ligjit të falimentimit, në emër të kreditorëve ndaj themeluesve, ortakëve, zyrtarëve, drejtorëve, agjentëve ose menaxherëve të lartë të ortakërisë së përgjithshme.

3. E drejta për të paraqitur kërkesa sipas paragrafit 2 të këtij neni skadon në momentin e mbylljes së rastit të falimentimit ose më së largu dy (2) vite nga dita e hapjes së rastit të falimentimit.

Neni 96

Shoqëritë Komandite

1. Në rastet kur debitori është shoqëri komandite e themeluar sipas ligjit për shoqëritë tregtare, në momentin e mbylljes së rastit ose para mbylljes së rastit, në përputhje me dispozitat e parapara në këtë kapitull dhe sipas ligjit për shoqëritë tregtare, Administratori do të ndërmarë të gjitha veprimet e nevojshme për shuarjen e shoqërisë komandite.

1.1. veprimet për shuarjen e shoqërisë komandite përjashtojnë të gjitha kërkesat për thirrje të mbledhjeve të ortakëve në shoqërinë komandite. Kërkesat e përjashtuara përfshijnë edhe përjashtimin e kërkesës për dërgimin e njoftimeve për thirrje të mbledhjeve ose mbajtjen e afarëdo takimi në lidhje me shuarjen e shoqërisë komandite;

1.2. veprimet e ndërmarra nga Administratori për shuarjen e shoqërisë komandite përfshijnë edhe dërgimin e njoftimeve ndaj regjistrave të biznesit dhe administratës tatimore në lidhje me mbylljen e rastit.

2. Vetëm Administratori ka të drejtë të paraqes kërkesa që rrjedhin nga një ligj tjetër përveq ligjit të falimentimit, në emër të kreditorëve ndaj themeluesve, ortakëve, zyrtarëve, drejtorëve, agjentëve ose menaxherëve të lartë të shoqërisë komandite.

3. E drejta për të paraqitur kërkesa sipas paragrafit 2 të këtij neni skadon në momentin e mbylljes së rastit të falimentimit ose më së largu dy (2) vite nga dita e hapjes së rastit të falimentimit.

Neni 97

Ortakët e përgjithshëm të ortakërive të përgjithshme dhe shoqërive komandite

1. Administratori paraqet kërkesë ndaj ortakut të përgjithshëm në ortakëri të përgjithshme ose shoqëri komandite, në rastet kur:

1.1. debitori është ortakëri e përgjithshme ose shoqëri komandite, dhe

1.2. pronat e ortakërisë ose shoqërisë komandite, kur shndërrohen në para të gatshme nuk janë të mjaftueshme për të paguar kërkesat e kreditorëve në tërësi; dhe

1.3. ortaku i përgjithshëm në ortakëri të përgjithshme ose në shoqëri kolektive ka përgjegjësi të pakufizuar personale për pagesën e kërkesave të tilla.

2. Vlera e kërkesave të tilla kufizohet në vlerën për të cilën ortaku i përgjithshëm ka përgjegjësi të pakufizuar personale për pagesë në përputhje me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

3. Për aq sa është praktike, Administratori fillimisht do të provojë të mbulojë pagesën e shumës

së kërkesave të kreditorëve nga cilido ortak i përgjithshëm i ortakërisë së përgjithshme ose shoqërisë komandite. Deri në vlerësimin e shumës e cila ka nevojë të paguhet për kërkesat e kreditorëve dhe e cila nuk mund të paguhet nga pasuria e ortakërisë ose shoqërisë komandite, gjykata mund të urdhëroj ortakun e përgjithshëm që të lejë pronën e caktuar si masë e sigurisë ose të urdhëroj ortakun e përgjithshëm të mos e bart pronën e caktuar.

4. Administratori ka kërkesë ndaj të gjitha pronave të secilit ortak të përgjithshëm në ortakëri të përgjithshme ose shoqëri komandite, për të mbuluar të gjithë shumën e kërkesave të kreditorëve ndaj ortakërisë së përgjithshme ose shoqërisë komandite. Kërkesat e realizuara nga Administratori sipas këtij paragrafi kanë trajtimin e njejtë në shpërndarje ndaj kreditorëve, sikurse të gjitha kërkesat tjera.

5. Nëse shumat e mbledhura nga Administratori nga pronat e përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni janë më të mëdha se çfarëdo shume që nuk ka mundur të mbledhet sipas paragrafit 3 të këtij neni, gjykata në seancë dëgjimore vendos për ndarje të tepricës së mbledhur dhe Administratori obligohet të shpërndajë tepricën ndaj ortakëve të përgjithshëm sipas vendimit të gjykatës.

Neni 98

Rastet me asete me vlerë të vogël

Nëse Administratori përcakton se pronat e pasurisë falimentuese kur shndërrohen në vlerë të parasë së gatshme nuk e tejkalon vlerën e dyqind (200) euro, dhe shuma e tillë nuk do të mund të paguajë kërkesat e kreditorëve në tërësi, Administratori i njofton kreditorët për përcaktimin e tillë të vlerës së pronës dhe paraqet kërkesë për braktisje të pronave sipas nenit 37 të këtij ligji. Nëse gjykata e aprovon kërkesën për braktisje të pronave, Administratori ndërmerr të gjitha veprimet për mbylljen e rastit, përfshirë të gjitha veprimet e parapara në këtë Kapitull. Administratori në këtë rast gëzon të drejtën në shpërblimin e tij, sikurse pronat e braktisura t'i kishte shitur dhe realizuar shpërndarjen.

Neni 99

Bizneset individuale

1. Bizneset individuale lirohen nga kërkesat ndaj aktiviteteve të tyre afariste sipas Nenit 105 të këtij Ligji.

2. Pas marrjes së lirit ose mbylljes së rastit, cilado që ndodh e para në kohë, përveq nëse gjykata nuk urdhëron ndryshe në seancë dëgjimore, debitori individual që është biznes individual do të ndërpres të gjithë aktivitetin afarist sipas emrit tregtar ose cilitdo emër që e ka përdorur në tregti, ose prej çfarëdo emri të ngjashëm me emrin e përdorur para marrjes së lirit ose mbylljes së rastit.

3. Në seancë dëgjimore gjykata lejon shitjen e emrit tregtar ose elementeve të tregtisë së debitorit individual të përdorura para marrjes së lirit, shitje e cila mund t'i bëhet debitorit individual ose cilëndo palë të interesuar.

Neni 100

Shitja e aseteve në procedurë të likuidimit

1. Administratori është përgjegjës për organizimin e shitjes së aseteve të shoqërisë tregtare në procedurë të likuidimit.

2. Gjatë procedurës së shitjes së aseteve, administratori mund të organizoj një ankand publik, mund të angazhoj një shtëpi të ankandeve ose mund të organizoj forma tjera të ofertimeve publike për shitje të aseteve të shoqërisë.

3. Gjatë përcaktimit të çmimit minimal të shitjes së aseteve të shoqërisë, Administratori do të merr për bazë vlerësimin e atyre aseteve nga një profesionist i angazhuar në përputhje me këtë Ligj dhe do të bëjë përpjekje maksimale që çmimi fillestar i aseteve të jetë në nivel ose ti afrohet shumës së borxheve të shoqërisë në falimentim.

4. Nëse dispozita e paragrafit 3 të këtij neni nuk mund të zbatohet, Administratori do të kërkoj leje nga Gjykata që asetet ti shes në çmimin me të lartë që ofrohet në treg, edhe pa procedura të ofertimit publik.

5. Gjykata ndaj kërkesës së Administratorit në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni vendos me Aktvendim.

Neni 101

Mbyllja e shoqërisë tregtare pas përfundimit të rastit

1. Administratori do të mbyll shoqërinë tregtare dhe do t'i ndërpres të gjitha aktivitetet afariste të debitorit, pas përfundimit të rastit.

2. Administratori sigurohet që pas përfundimit të rastit, biznesi të fshihet nga regjistri i bizneseve dhe nga administrata tatimore si biznes aktiv.

Neni 102

Shndërrimi i rastit në riorganizim

1. Me aprovim të gjykatës, Administratori mund të shndërroj një procedurë të likuidimit në procedurë të riorganizimit, nëse Administratori i dëshmon gjykatës se kreditorët e pasiguruar do të realizonin në mase me të madhe përmbyshjen e kërkesave të tyre.

2. Në rast të shndërrimit në riorganizim, Administratori do të mbetet përfaqësues i pasurisë falimentuese.

3. Gjykata për shndërrimin e rastit nga likuidimi në riorganizim vendos me Aktvendim.

Neni 103

Mbyllja e rastit

1. Gjykata e mbyll rastin kur:

1.1. administratori ka shndërruar të gjitha pronat e pasurisë falimentuese në para të gatshme, ose ka shndërruar të gjitha ato prona që kanë mundur të shndërrohen në para të gatshme dhe ka bërë shpërndarjen e të gjitha pronave të pasurisë falimentuese të kreditorët; ose

1.2. administratori e njofton gjykatën se administrimi i mëtutjeshëm i rastit nuk do të sjell rritje të shpërndarjes për kreditorët e pasiguruar.

2. Gjykata për mbyllje të rastit vendos me Akvendimin për përfundim të procedurës së likuidimit.

KAPITULLI VIII

LIRIMI NGA BORXHET DHE MBYLLJA E RASTIT

Neni 104

Lirimi (lirimet)

1. Lirimi nënkupton shlyerjen e borxheve dhe sipas këtij ligji:

1.1. zhvlerëson çfarëdo aktgjykimi të nxjerr në çfarëdo kohe, aktgjykim i cili krijon përgjegjësi të plotë personale për debitorin ndaj një kërkesë, për të cilat debitori ka pranuar lirim sipas këtij ligji;

1.2. ka efektin e vendimit të plotfuqishëm të gjykatës dhe vepron si ndalesë ndaj fillimit ose vazhdimit të çfarëdo procedure ose veprimi kundër debitorit për mbledhje të borxhit, për kthim të borxhit ose për çfarëdo kërkesë për kompensim, pa marrë parasysh se a ka pasur debitori përgjegjësi të plotë personale ndaj atij borxhi.

Neni 105

Vlefshmëria në kohë e lirimit

1. Përveç përjashtimeve të parapara në Kapitullin VIII të këtij ligji, debitori i cili është individ lirohet në tërësi nga të gjitha kërkesat që kanë ekzistuar në periudhën para fillimit të procedurës së falimentim deri kur ka filluar procedura e falimentimit. Debitori i cili është individ i shlyhen të gjitha borxhet e krijuara deri:

1.1. në momentin e konfirmimit të planit të riorganizimit; ose

1.2. deri në momentin e mbylljes së rastit të likuidimit.

2. Debitori i cili nuk është individ do të lirohet nga borxhet ndaj të gjitha kërkesave që kanë ekzistuar deri:

2.1. në momentin e konfirmimit të planit të riorganizimit; ose

2.2. deri në momentin e mbylljes së rastit të likuidimit ose njoftimin e regjistratit të bizneseve dhe administratës tatimore mbi mbylljen e rastit, cilado nga këto të ndodh e fundit.

Neni 106

Përjashtimet nga lirim në përgjithësi; mos-shpalosja; mungesa e bashkëpunimit

1. Debitorit nuk do t'i jepet lirim nga borxhet kur një palë e interesuar e dëshmon se debitori ose një personi brendshëm i debitorit:

1.1. nuk ka bashkëpunuar me Administratorin;

1.2. ka fshehur një pjesë të pasurisë nga kreditorët, gjykata dhe Administratori;

1.3. ka dorëzuar çfarëdo dokumenti i cili ka qenë i falsifikuar, mashtrues ose ç'orientues;

1.4. i ka ndryshuar librat dhe shënimet tatimore gjatë periudhës një (1) vjeçare para inicimit të procedurës së falimentimit, duke i bërë këto libra dhe shënime të pasakta, mashtruese ose ç'orientuese;

1.5. nuk i ka mbajtur në mënyrë të rregullt librat dhe shënimet tatimore gjatë periudhës një-vjeçare para inicimit të procedurës së falimentimit. Mënyrë e rregullt ndër të tjera nënkupton edhe mundësinë e shikimit dhe kuptimit të librave dhe të dhënave tatimore nga një person i arsyeshëm; ose

1.6. nëse bëhet fjalë për debitorin si individ, ka pranuar një lirim nga borxhet gjatë dhjetë (10) viteve të fundit, llogaritur prej periudhës së inicimit të procedurës së falimentimit.

Neni 107

Përrjashtimet nga lirimi për kërkesat specifike të kreditorëve

1. Sipas këtij ligji nuk lirohet nga borxhi debitori individual nga cilado prej:

1.1. kërkesave që nuk kanë të bëjnë me aktivitete afariste të debitorit;

1.2. kërkesave nga marrëdhëniet familjare sipas nenit 58 të këtij ligji;

1.3. kërkesave nga kompenzimi i viktimave të dhunës sipas nenit 58 të këtij ligji;

1.4. kërkesave tatimore të krijuara për periudhën një (1) vjeçare nga dita e hapjes së rastit;

1.5. kërkesave të papërfshira në listën e kërkesave të dorëzuara sipas Kapitullit IV të këtij ligji;

1.6. kërkesave për të cilat kreditori nuk ka pranuar njoftim të rregullt dhe si rezultat nuk ka mundur t'i dorëzojë gjykatës kërkesën dhe dëshmitë në kohë;

1.7. kërkesave që kanë lindur si rezultat i mashtrimit nga debitori;

1.8. kërkesave që kanë lindur si rezultat i shkeljes së detyrimit për mirëbesim të debitorit;

1.9. kërkesave që nuk rezultojnë nga kontratat por të cilat janë krijuar si rezultat i dëmtimit të qëllimshëm të shkaktuar nga debitori ndaj një entiteti tjetër ose pronave të një entiteti tjetër.

Neni 108

Prona e përrjashtuar e debitorëve individual

Sendet që përrjashtohen nga ekzekutimi i detyrueshëm sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën

Përmbarimore, përjashtohen nga pasuria e falimentimit.

Neni 109

Mos-diskriminimi ndaj debitorëve të liruar

1. Një Organ qeveritar nuk mund të refuzojë, të marrë, suspendojë ose të refuzojë vazhdimin e një licence, leje ose ndonjë të drejte tjetër të ngajshme ndaj debitorit, e cila mund të diskriminojë debitorin për t'u punësuar, mund ti shkakojë ndërprerje të marrëdhies së punës ose mund ti shkakojë çfarëdo diskriminimi të lidhur me marrëdhënien e punës. E njëjta vlen edhe për personat të cilët kanë pasur një lidhje me debitorin. Ky diskriminim nuk mund të ndodh ndaj debitorit ose një personi që ka pasur një lidhje me debitorin vetëm për arsye se debitori:

1.1. ka qenë debitor sipas këtij ligji;

1.2. ka qenë josolvent para fillimit të rastit sipas këtij ligji ose gjatë zhvillimit të rastit, por para se debitorit i është akorduar ose refuzuar lirimi nga borxhet; ose

1.3. nuk e ka paguar një detyrim që është i liruar sipas këtij ligji;

1.4. asnjë punëdhënës privat nuk mund të ndërprejë marrëdhien e punës ose ta diskriminojë individin që ka qenë debitor sipas këtij Ligjit, ose një person që ka pasur lidhje me debitorin, vetëm pse:

1.4.1. ka qenë debitor sipas këtij ligji;

1.4.2. ka qenë josolvent para fillimit të rastit sipas këtij ligji ose gjatë zhvillimit të rastit, por para se debitorit i është akorduar ose refuzuar lirimi nga borxhet; ose

1.4.3. nuk e ka paguar një detyrim që është i liruar sipas këtij ligji.

Neni 110

Efektet ndaj bashkë-detyruesve

Lirimi që i është dhënë debitorit në lidhje me një kerkësë të një entiteti nuk ka asnjë efekt në obligimin e një debitorit, bashkë-detyruesi tjetër që mund të ketë ndaj atij entiteti ose pronave të tij.

Neni 111

Efekti ndaj pagesave vullnetare

Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk e ndalon debitorin nga pagesa vullnetare e çfarëdo kerkese të liruar pas mbylljes së rastit.

Neni 112

Efektet e lirimit nga borxhi pas mbylljes së rastit

1. Nëse një palë e interesuar bënë përpjekje të drejtëpërdrejta ose të tërthorta për të realizuar një kerkësë e cila është liruar sipas këtij ligji ndaj një individi, individi do të ketë të drejtë të

kërkojë nga pala e interesuar:

1.1. ndërprerje të menjëhershme të çfarëdo përpjekje për realizim të kërkesës së liruar; dhe

1.2. kompensim të dëmit të shkaktuar, i cili nuk mund të jetë më pak se:

1.2.1. një mijë (1,000) Euro; ose

1.2.2. trefishi i vlerës së kërkesës të cilën pala e interesuar ka provuar ta realizojë.

2. Kompensimi i dëmit për shkelje të dispozitave të këtij ligji në lidhje me lirimet gjithashtu përfshinë, por nuk kufizohet në shpenzimet e avokatëve dhe kompensim të dëmeve jomateriale siç janë dëmtimi i reputacionit, turpërimi.

KAPITULLI IX FALIMENTIMI NDËRKOMBËTAR

Neni 113

Dispozitat të përgjithshme të Kapitullit IX; Fushëveprimi

1. Kapitulli IX i këtij Ligji zbatohet në rastet kur:

1.1. një gjykatë e huaja ose nga një përfaqësues i huaj i pasurisë falimentuese i kërkon ndihmë gjykatës kompetente në Kosovë në lidhje me një procedurë të huaj falimentuese; ose

1.2. kërkohet ndihmë në një shtet i huaj në lidhje me procedurat e falimentimit sipas këtij Ligji; ose

1.3. një procedurë e huaj e falimentimit dhe një procedurë e falimentimit sipas këtij ligji janë duke u zhvilluar në të njëjtën kohë; ose

1.4. kreditorët ose personat tjerë të interesuar në një shtet të huaj kanë interes për të kërkuar fillimin e procedurës ose pjesëmarrjen në procedurë sipas këtij Ligji.

2. Kapitulli IX i këtij Ligji nuk aplikohet ndaj procedurave ku palë janë debitorët jo të përshtatshëm sipas këtij Ligji.

Neni 114

Detyrimet ndërkombëtare të Kosovës

Në rastin kur ky Ligj është në kolizion me obligimet ndërkombëtare të Kosovës të cilat rrjedhin nga një traktat ose ndonjë marrëveshje tjetër ndërkombëtare të lidhur me një ose më shumë shtete, dispozitat e atij traktati ose asaj marrëveshjeje mbizotërojnë obligimet e këtij Ligji.

Neni 115

Gjykata kompetente

Njohja e procedurave të huaja dhe bashkëpunimi me gjykatat e huaja në përputhje me dispozitat e këtij ligji zbatohet nga gjykata e cila është gjykatë kompetente për rastet e falimentimit.

Neni 116

Autorizimet e përfaqësuesit të pasurisë falimentuese për të vepruar në shtetin e huaj

Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese është i autorizuar të veprojë në shtetin e huaj në emër të procedurës e cila zhvillohet sipas këtij ligji, në përputhje me autorizimet e parapara në ligjin e huaj.

Neni 117

Përgjashtimet sipas rendit publik

Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk e përjashton të drejtën e Gjykatës për të refuzuar ndërmarrjen e një veprimi sipas këtij Ligji, nëse një veprim i tillë është në kundërshtim me rendin publik të Republikës së Kosovës.

Neni 118

Ndihma shtesë sipas ligjeve tjera

Asnjë dispozitë e këtij ligji nuk e kufizon kompetencën e gjykatës ose të përfaqësuesit të pasurisë falimentuese të ofrojë mbështetje shtesë ndaj përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese në përputhje me ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Neni 119

Interpretimi

Interpretimi i kapitullit IX të këtij ligji, do të bëhet sipas burimit ndërkombëtar të tij, duke promovuar rregulla në zbatimin unik mbi bazën e mirebesimit.

Neni 120

E drejta për çasje të drejtpërdrejtë

Përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese ka të drejtë t'i paraqitet drejtpërdrejt gjykatës së Kosovës.

Neni 121

Jurisdiksioni i kufizuar

Fakti se përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese ka të drejtë t'i paraqitet drejtpërdrejt gjykatës së Kosovës, nuk e nënshton përfaqësuesin e pasurisë së huaj falimentuese ose asetet e huaja të debitorit nën jurisdiksionin e gjykatave të Kosovës përveq për qëllime të paraqitjes së drejtpërdrejt në gjykata të Kosovës.

Neni 122**Kërkesa e përfaqësuesit të huaj për inicim të procedurave sipas këtij ligji**

Një përfaqësues i pasurisë së huaj falimentuese ka të drejtë të kërkojë fillimin e procedurave sipas këtij Ligji nëse kushtet për fillimin e një procedure të tillë plotësohen.

Neni 123**Pjesëmarrja e përfaqësuesit të huaj në procedurat sipas këtij ligji**

Pas njohjes së procedurës së huaj, përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese mund të marrë pjesë në procedurë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 124**Çasja e kreditorëve të huaj në procedurat sipas këtij ligji**

1. Nën kushtet e parapara në paragrafin 2 të këtij neni, kreditorët e huaj gëzojnë të drejtat e njejta në lidhje me iniciimin dhe pjesëmarrjen në procedurë të falimentimit sipas këtij ligji, sikurse kreditorët në Kosovë.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk e afekton rankimin e kërkesave në procedurat sipas këtij Ligji, përveq se kërkesat e kreditorëve të huaj nuk mund të rradhiten më poshtë se kreditorët e pasiguruar pa prioritet.

Neni 125**Kërkesa për njohje të procedurës së huaj**

1. Një përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese i paraqet kërkesë Gjykatës për njohje të procedurës së huaj në të cilën ai është i emëruar si përfaqësuesi i pasurisë falimentuese.

2. Kërkesës për njohje të procedurës së huaj duhet t'i bashkangjitet:

2.1. një kopje e vërtetuar e vendimit për inicim të procedurës së huaj dhe emërim të përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese; ose

2.2. një certifikatë nga gjykata e huaj e cila konfirmon ekzistimin e procedurës së huaj dhe emërimin e përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese; ose

2.3. në mungesë të provave të parapara në paragrafet 2.2 dhe 2.3 të këtij neni, cfarëdo prove të pranueshme për gjykatë e cila dëshmon ekzistimin e procedurës së huaj dhe emërimin e përfaqësuesit të pasurisë së huaj.

3. Kërkesës për njohje të procedurës së huaj duhet t'i bashkangjitet edhe një deklaratë për të gjitha procedurat e huaja në të cilat është palë debitori, të cilat janë të njohura për përfaqësuesin e pasurisë së huaj falimentuese.

4. Gjykata mund t'i kërkojë përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese edhe përkthimin e dokumentacionit të dorëzuar sipas këtij neni, në njërën nga gjuhët zyrtare të Kosovës.

Neni 126**Prezumimet në lidhje me njohjen e procedurës së huaj**

1. Nëse vendimi ose çertifikata e përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 125 të këtij ligji, thekson se procedura e huaj është procedurë në kuptimin e perkufizimeve të këtij ligji dhe se përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese është person në kuptimin e perkufizimeve të këtij ligji, gjykata prezumon se ato të dhëna janë të sakta.
2. Gjkata prezumon se të gjitha dokumentet që janë deponuar në mbështetje të kërkesës për njohje të procedurës së huaj janë autentike, pa pasur nevojë për legalizimin e tyre.
3. Përveq nëse dëshmohet e kundërta, selia e regjistruar e debitorit ose adresa e vendbanimit e tij në rastet e debitorit individual prezumohet të jenë vendi kryesor i veprimit të debitorit.

Neni 127**Vendimi për njohje të procedurës së huaj**

1. Gjkata vendos për njohjen e procedurës së huaj nëse:
 - 1.1. procedura e huaj është procedurë në kuptim të paragrafit 2.1 të nenit 3 të këtij ligji;
 - 1.2. përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese është person ose trupë në kuptim të paragrafit 2.4 të nenit 3 të këtij ligji;
 - 1.3. kërkesa i plotëson kushtet e parapara në paragrafin 2 të nenit 125 të këtij Ligji;
 - 1.4. kërkesa është dërguar ne gjykate sipas nenit 115 të këtij ligji.
2. Procedura e huaj njihet si:
 - 2.1. procedurë e huaj kryesore nëse si procedurë është duke u zhvilluar në shtetin ku debitori ka vendin kryesor të aktivitetit; ose
 - 2.2. procedurë e huaj jo-kryesore nëse si procedurë është duke u zhvilluar në shtetin ku debitori ka seli të themeluar në kuptimin të nenit 3, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.6 të këtij ligji.
3. Kërkesa për njohje të procedurës së suaj vendoset nga gjykata në afatin shtatë (7) ditor pas paraqitjes së kërkesës së kompletuar në Gjykatë.
4. Dispozitat e neneve 125, 126, 127, 128 të këtij ligji nuk e ndalojnë ndryshimin ose ndërprerjen e njohjes së procedurës së huaj nëse bazat për dhënien e vendimit për njohje kanë ndryshuar pjesërisht ose në tërësi ose më nuk ekzistojnë.

Neni 128**Informacionet pasuese**

1. Nga moment i paraqitjes së kërkesës për njohje të procedurës së huaj, përfaqësuesi i

pasurisë së huaj falimentuese do të informojë gjykatën menjëherë nëse:

1.1. ndodh çfarëdo ndryshimi substancial në statusin e procedurës së huaj falimentuese ose statusin e përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese;

1.2. përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese vjen në dijeni për çfarëdo procedure tjetër të huaj të inicuar ndaj debitorit.

Neni 129

Masat që mund të vendosen pas kërkesës për njohje të procedurës së huaj

1. Nga momenti i paraqitjes së kërkesës për njohje deri në momentin e vendosjes së kërkesës, gjykata mundet që me kërkesë të përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese të udhërojë masë të përkohshme kur është e nevojshme për ruajtjen e aseteve të debitorit ose interesave të kreditorëve, përfshirë:

1.1. vendosjen e moratoriumit ndaj aseteve të debitorit;

1.2. vendosjen nën administrim të përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese të të gjitha ose një pjese të aseteve të debitorit që gjenden në Kosovë ose nën administrimin e një personi tjetër sipas vendimit të Gjykatës, me qëllim të ruajtjes së vlerës së aseteve të cilat sipas natyrës së tyre ose rrethanave tjera mund të prishen, janë në rrezik të zhvlersimit ose të rrezikuara në ndonjë mënyrë tjetër;

1.3. çfarëdo mase të paraparë në paragrafet 1.3, 1.4 dhe 1.7 të nenin 131 të këtij ligji.

2. Përveq nëse vazhdohet sipas paragrafit 1.6 të nenit 131 të këtij ligji masa e përkohshme sipas këtij neni ndërpritet në momentin kur vendoset për njohje të procedurës së huaj.

3. Gjykata refuzon lëshimin e masës së përkohshme sipas këtij neni nëse masa e tillë mund të ndërhyjë në administrimin e procedurës së huaj kryesore.

Neni 130

Efektet e njohjes së procedurës së huaj kryesore

1. Prej momentit të njohjes së procedurës së huaj si procedurë e huaj kryesore:

1.1. vendoset moratorium mbi iniciimin ose vazhdimin e veprimeve kundër aseteve të debitorit, të drejtave ose detyrimeve të debitorit;

1.2. vendoset moratorium ndaj përmbarimit ndaj aseteve të debitorit; dhe

1.3. pezullohet e drejta e debitorit për të transferuar, ngarkuar ose në çfarëdo mënyrë disponuar me asetet e tij.

2. Fushëveprimi, ndryshimi ose ndërprerja e moratoriumit të referuara në paragrafin 1 të këtij neni rregullohen sipas dispozitave të parapara në Kapitullin IV të këtij Ligji.

3. Paragrafi 1.1 i këtij neni nuk e kufizon të drejtën për të inicuar veprime individuale ose procedura të nevojshme për të ruajtur një kërkesë ndaj debitorit.

4. Paragrafi 1 i këtij neni nuk e kufizon të drejtën për të kërkuar fillimin e procedurave sipas këtij Ligji ose të drejtën për të paraqitur një kërkesë në procedura të filluara sipas këtij Ligji.

Neni 131

Masat që mund të urdhërohen pas njohjes së procedurës së huaj

1. Prej momentit të njohjes së procedurës së huaj nga Gjykata, qoftë ajo procedurë kryesore ose jo-kryesore, kur është e nevojshme të mbrohen asetet e debitorit ose interesat e kreditorëve, gjykata mundet që me kërkesë të përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese të urdhërojë masën e përshtatshme, përfshirë:

1.1. vendosjen e moratoriumit ndaj inicimit ose vazhdimit të veprimeve të ndërmarra ose procedurave të inicuar kundër aseteve të debitorit, të drejtave, detyrimeve ose përgjegjësi të debitorit, dëri në masën që ndaj tyre nuk është vendosur moratorium sipas paragrafit 1.1 të nenit 130 të këtij ligji;

1.2. vendosjen e moratoriumit ndaj veprimeve përmbarimore ndaj asteve të debitorit, dëri në masën që ndaj tyre nuk është vendosur moratorium sipas paragrafit 1.2 të nenit 130 të këtij ligji;

1.3. pezullohet e drejta e debitorit për të transferuar, ngarkuar ose në çfarëdo mënyrë disponuar me asetet e tij, deri në masën që një pezullim i tillë nuk është vendosur sipas paragrafi 1.3 të nenit 130 të këtij ligji;

1.4. vendosjen për marrjen në pyetje të dëshmitarëve, mbledhjen e provave ose dërgimin e informacioneve në lidhje me asetet e debitorit, punët e debitorit, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë;

1.5. vendosjen nën administrim të përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese ose të një personi tjetër sipas vendimit të gjykatës, të aseteve të debitorit që gjenden në Kosovë;

1.6. zgjatjen e masave të udhëruara sipas paragrafit 1 të nenit 130 të këtij ligji;

1.7. udhërimin e masave shtesë që mund të jenë në dispozicion për përfaqësuesin e pasurisë së huaj falimentuese sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

2. Pas vendimit për njohje të procedurës së huaj, kryesore ose jo-kryesore, gjykata mund t'i besojë përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese ose një personi tjetër sipas vendimit të gjykatës, shpërndarjen e një pjese ose të gjitha pasurisë së debitorit të ndodhur në Kosovë, nëse gjykata sigurohet se interesat e kreditorëve në Kosovë janë të mbrojtura në mënyrë të duhur.

3. Gjatë vendosjes për masë në favor të përfaqësuesit të procedurës së huaj jo-kryesore në përputhje me këtë nen, gjykata duhet të sigurohet se masa ndërlidhet me asetet që sipas ligjeve të Kosovës duhet administruar në procedurën e huaj jo-kryesore ose lidhet me informacionet e nevojshme në atë procedurë.

Neni 132**Mbrojtja e kreditorëve dhe personave tjerë të interesuar**

1. Gjatë vendosjes për lëshimin ose refuzimin e masës sipas nenit 125 ose 131 të këtij ligji, ose gjatë ndryshimit ose ndërprerjes së masës sipas paragrafit 3 të këtij neni, gjykata duhet të sigurohet se interesat e kreditorëve, palëve të interesuara dhe të debitorit janë të mbrojtura në mënyrë të drejtë.
2. Gjkata mund të kushtëzojë lëshimin e masës sipas nenit 129 dhe nenit 131 të këtij ligji nën kushtet të cilat Gjykata i konsideron të përshtatshme.
3. Gjykata mundet që sipas kërkesës së përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese ose sipas kërkesës së personit të prekur nga masa e lëshuar sipas nenit 129 ose 132 të këtij ligji ose sipas iniciativës të vetë Gjykatës, të ndryshojë ose ndërprejë masën e tillë.

Neni 133**Kërkesat për shmangie të veprimeve të dëmshme për kreditorët**

1. Prej momentit të vendosjes për njohje të procedurës së huaj, përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese mund të inicioj kërkesë për shmangie të veprimeve sipas Kapitullit IV të këtij Ligji.
2. Kur procedura e huaj është procedurë jo-kryesore, gjykata duhet të sigurohet se veprimet ndërlidhen me asetet të cilat sipas ligjeve të Kosovës duhet të administrohen në procedurë jo-kryesore të huaj.

Neni 134**Intervenimi i përfaqësuesit të huaj në procedurat brenda Kosovës**

Prej momentit të njohjes së procedurës së huaj, përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese mund të paraqitet si intervenues në çfarëdo procedure në të cilën debitori është palë, nën kushtet që kërkesat e ligjeve të Kosovës janë plotësuar.

Neni 135**Bashkëpunimi dhe komunikimi i drejtpërdrejtë në mes të gjykatës së Kosovës dhe gjykatës së huaj ose përfaqësuesit të huaj**

1. Në rastet e parapara në nenin 113 të këtij ligji, gjykata do të bashkëpunojë në maksimumin e mundshëm me gjykatën e huaj ose me përfaqësuesin e pasurisë së huaj falimentuese, drejtpërdrejtë ose përmes përfaqësuesit të pasurisë së huaj falimentuese.
2. Gjykata ka të drejtë të komunikojë drejtpërdrejtë me gjykatën e huaj ose të kërkojë informata nga gjykata e huaj ose nga përfaqësuesi i pasurisë së huaj falimentuese.

Neni 136**Bashkëpunimi dhe komunikimi i drejtpërdrejtë në mes të përfaqësuesit të pasurisë falimentuese në Kosovë me gjykatat e huaja dhe përfaqësuesit e huaj**

1. Në çështjet e referuar në nenin 113 të këtij ligji, përfaqësuesi i pasurisë falimentuese, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij nën mbikqyrje të gjykatës, do të bashkëpunojë maksimalisht me

përfaqësuesin e pasurisë së huaj falimentuese ose gjykatën e huaj.

2. Përfaqësuesi i pasurisë falimentuese ka të drejtë që gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe nën mbikqyrje të gjykatës të komunikojë drejtpërdrejtë me gjykatën e huaj dhe përfaqësuesin e huaj të pasurisë falimentuese.

Neni 137

Format e bashkëpunimit

1. Bashkëpunimi i referuar në nenet 135 dhe 136 të këtij ligji do të zbatohet përmes mjeteve adekuate, përfshirë:

1.1. emërimin e një personi ose trupe përgjegjëse për të vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës;

1.2. komunikimin e informative në çfarëdo mënyre e cila konsiderohet e përshtatshme për gjykatën;

1.3. koordinimin e administrimit dhe mbikqyrjes së aseteve dhe punëve të debitorit;

1.4. aprovimin ose implementimin e marrëveshjeve të ndërlidhura me koordinimin e procedurave nga gjykata;

1.5. koordinimin e procedurave të njëkohësishme të lidhura me debitorin e njëjtë;

1.6. seanca dëgjimore të përbashkëta në mes të gjykatës së Kosovës dhe gjykatave të shteteve tjera të mbajtura në mënyra të ndryshme elektronike.

Neni 138

Procedurat e njëkohësishme – fillimi i procedurave sipas këtij ligji pas njohjes së një procedure të huaj kryesore

Pas njohjes së procedurës së huaj kryesore, procedura sipas këtij Ligji mund të fillohet vetëm nëse debitori ka asete në Kosovë; efektet e procedurës janë të kufizuara vetëm ndaj aseteve të debitorit të cilat ndodhen në Kosovë dhe deri në masën sa është e nevojshme për implementimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të paraparë në nenet 135 deri 137 të këtij ligji, ndaj aseteve tjera të debitorit të cilat sipas ligjeve të Kosovës duhet të administrohen në këtë procedurë.

Neni 139

Koordinimi i procedurës sipas këtij ligji me procedurën e huaj

1. Kur një procedurë e huaj dhe një procedurë sipas këtij Ligji ndodhin në të njëjtën kohë ndaj debitorit të njëjtë, gjykata do të kërkojë bashkëpunim dhe koordinim sipas dispozitave të parapara në nenet 135 deri 137 të këtij ligji, dhe do të zbatohen dispozitat si vijon:

1.1. kur procedura në Kosovë është duke u zhvilluar në kohën e paraqitjes së kërkesës për njohjen e procedurës së huaj:

1.1.1. çfarëdo mase e urdhëruar sipas nenit 129 ose nenit 131 të këtij ligji,

duhet të jetë konsistente me procedurën që është duke u zhvilluar në Kosovë; dhe

1.1.2. nëse procedura e huaj është njohur në Kosovë, neni 126 të këtij ligji, nuk aplikohet;

1.2. Kur procedura në Kosovë fillon pas njohjes së procedurës së huaj, ose pas paraqitjes së kërkesës për njohje të procedurës së huaj:

1.2.1. çfarëdo mase e urdhëruar sipas nenit 129 ose nenit 131 të këtij ligji, do të rishikohet nga gjykata dhe do të ndryshohet ose ndërpritet nëse nuk është konsistente me procedurën në zhvillim në Kosovë; dhe

1.2.2. nëse procedura e huaj është procedurë e huaj kryesore, moratoriumi dhe ndërprerja të parapara në paragrafin 1 të nenit 130 të këtij ligji, do të ndryshohen ose ndërpritin sipas paragrafit 2 të nenit 130 të këtij ligji, nëse nuk janë konsistente me procedurat në zhvillim në Kosovë;

1.3. Gjatë urdhërimit, vazhdimit ose ndryshimit të një mase që i është lëshuar një përfaqësuesi të huaj të pasurisë falimentuese të një procedure të huaj jo-kryesore, gjykata duhet të sigurohet se sipas ligjeve të Kosovës, asetet e tilla duhet administruar në një procedurë të huaj jo-kryesore ose kanë të bëjnë me informata të nevojshme për atë procedurë.

Neni 140

Koordinimi i më shumë se një procedure të huaj

1. Në çështjet e referuara në nenin 107 të këtij ligji, në lidhje me dy ose më shumë procedura të huaja ndaj debitorit të njejtë, gjykata do të kërkojë bashkëpunim dhe koordinim sipas neneve 131 dhe 132 të këtij ligji dhe do të zbatohen dispozitat si vijon:

1.1 çfarëdo mase e urdhëruar sipas nenit 129 ose nenit 131 të këtij ligji, duhet të jetë konsistente me procedurën që është duke u zhvilluar në Kosovë; dhe

1.2. kur procedura në Kosovë fillon pas njohjes së procedurës së huaj, ose pas paraqitjes së kërkesës për njohje të procedurës së huaj, çfarëdo mase e urdhëruar sipas nenit 129 ose nenit 131 të këtij ligji, do të rishikohet nga gjykata dhe do të ndryshohet ose ndërpritet nëse nuk është konsistente me procedurën në zhvillim në Kosovë; dhe

1.3. nëse pas njohjes së procedurës së huaj jo-kryesore, një procedurë tjetër e huaj jo-kryesore gjithashtu njihet nga gjykata, gjykata do të urdhërojë, ndryshim ose ndërprerje të masës me qëllim të lehtësimit të koordinimit të procedurave.

Neni 141

Prezumimi i josolvenës bazuar në njohjen e procedurës së huaj kryesore

Përveç nëse dëshmohet e kundërta, njohja e procedurës së huaj kryesore me qëllim të inicimit të procedurave sipas këtij Ligji nënkupton se debitori është në situatë të josolvencës.

Neni 142**Rregulla e pagesës në procedurat e njëkohësishme**

Pa paragjykuar kërkesat e siguruara ose të drejtat pronësore mbi sendet, kreditori i cili pranon pagesë të pjesshme në lidhje me kërkesën e tij në procedurat sipas një ligji të falimentimit në shtetin e huaj nuk mund të pranojë pagesë për kërkesën e njejtë sipas këtij Ligji në lidhje me debitorin e njejtë, përderisa pagesa ndaj kreditorëve tjerë të klasës së njejtë është proporcionalisht më e vogël se pagesa të cilën kreditori veq se e ka pranuar.

KAPITULLI X**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE****Neni 143****Zbatimi i dispozitave të këtij ligji ndaj rasteve të falimentimit të hapura në gjykatë**

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Gjykata do të zbatoj dispozitat e këtij ligji, për të gjitha rastet që janë hapur në Gjykatë para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që janë ende në procedurë pranë Gjykatës.

Neni 144**Shfuqizimi i ligjeve të mëhershme**

Ky ligj shfuqizon ligjin nr. 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim dhe ligjin nr. 02/L-115 mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/4 për likuidimin dhe riorganizimin e personave juridik në falimentim.

Neni 145**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L-083

9 qershor 2016

Shpallur me dekreten Nr. DL-019-2016, datë 23.06.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.

